

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 250, Gusht 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Prof. dr. Tonin Gjuraj dekretohet në detyrën e Rektorit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"...



NGA MANIFESTIMI "DITA E PLISIT" EDICIONI XI

Me 28 korrik u mbajt Dita e Plisit edicioni XI, faza e tretë, u mbajt në Oden e gjeneralëve Shaban e Bedri Shala, në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit.

Në orët e hershme të mëngjesit Plisbardashët ia kishin mësy fshatit Gjergjicë komuna e Drenasit, çdo gjë ishte për ti prit mysafiret plisbardashë.

3

DREJTIMI BASHKË-KOHOR I SHKOLLËS, KËRKESË PARËSORE PËR REALIZIMIN E MISIONIT TË SAJ

Drejtimi shkollës është parësor, jo vetëm për rëndësinë dhe peshën që ka një drejtues, por sepse nga mënyra e drejtimit dhe menaxhimit të punëve

6

BASHKIM ARTISTËSH DHE TROJESH SHQIPTARE NË SKENËN E NJË FESTIVALI

Festivali i përvitshëm Shqiptar në Miçigan, pasqyrë e shkëlqyer e një bashkësie të bashkuar dhe patriot.

Ky festival, siç përcaktohet edhe në nëntitullin e këtij shkrimi, është një punë të pandërprerë...

7

TRE DEPUTET TË NJË SHTËPIE

Çdo kohë ka fytyrën dhe identiten e saj që nuk ngjason me një tjetër. Kuvendi Kombëtar Kushtetues i quajtur edhe Asmbleja Kushtetuese (u krijua pas kapitullimit të pa nderë të Italisë fashiste dhe ardhjes së forcave naziste gjermane). Strategjia gjermane ishte t'i qetësojë dhe përvetësojë shqiptarët, t'iu lejoi që këta të formojnë strukturat e veta për të nivelat e një pushtetit...

14

Prof. dr. Tonin Gjuraj dekretohet në detyrën e Rektorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”...

Prof. Dr. Tonin Gjuraj është tashmë rektori i ri i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

“Jam plot besim se, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” nis sot një rrugë të re me zgjedhjen e Prof. Tonin Gjuraj në detyrën e Rektorit të Universitetit. Mirënjohës për grupin e pedagogëve dhe studentet, që me votën e tyre i japin sot mundësinë Universitetit të Shkodrës të nisë një rrugë drejt ringritjes, dhënies së mundësive e përkrahjes së çdo të riu të rajonit tonë që do ta zgjedhë shkollimin në Shkodër, për t'i dhënë krenarinë e një diplome me emrin e “Luigj Gurakuqit”. Shumë suksese të gjithë të zgjedhurve, në zgjedhjet e sotme. Jam i sigurt që tani Universiteti do të jetë një partner i denjë në sfidën e zhvillimit të Shkodrës”, thekson Kryetari i Bashkise, z. Benet Beci

Rikthimi i Tonin Gjurajt, ikja e “Luigj Gurakuqit” nga provincializmi!

Pamfleti, shkruan: Tonin Gjurajt në Shkodër, është një shans i rëndësishëm për ta ndarë “Luigj Gurakuqin” nga një kuvli arsimor province, e për ta bërë edhe më të lavdishëm se ILA-ja e kohës...

“Luigj Gurakuqi”, si institucioni më i rëndësishëm i Arsimit në Shkodër ka pasur dy jetë. Jetën e parë si Institut i Lartë i Arsimit dhe jetën e dytë si Universitet.

Si Institut i Lartë Arsimor, ku dilnin mësues nga të gjitha rajonet e Shqipërisë, “Luigj Gurakuqi” arriti të bëhej më i miri ndër të gjithë homologët e tij në vend.

Niveli i përgatitjes së arsimtarëve, por edhe kërkimi shkencor në këtë fushë i pedagogëve të këtij institucioni njohu respekt e autoritet në nivel kombëtar.

Emra të mëdhenj si Jup Kastrati, Mahir Hoti, Vehbi Hoti, Gëzim Hoxha e të tjerë e të tjerë, u kthyen në shkencëtarë të një niveli kombëtar.

Por pas vitit 1990, Instituti i Lartë i Shkodrës, që ka nxjerrë me mijëra mësues nga i gjithë vendi, u bë Universitet. E si i tillë, përveç lëndëve të përfshira në mësuesi, pra Cikël fillor, Gjuhë - Letërsi, Histori - Gjeografi, Matematikë, Bio-Kimi, Fizikë, u shtua në fillim juridiku, më pas ekonomiku, e më vonë gazetaria, e madje edhe infermiera.

Në mënyrë të dhimbshme, “Luigj Gurakuqi” u kthye si gjithandej në vend, në një megakioskë që prodhonte tallava, diploma pa vlerë e mitomanë e delirantë pa fund.


Emrat më të njohur sot që kanë dalë nga ai institucion, janë të kohës kur ishte ILA.

Pikërisht kjo gjendje kaotike e ka kthyer Universitetin e Shkodrës, një vend ku prindërit, por edhe maturantët nuk duan të regjistrohen. Çdo vit e më shumë, rrallohen të regjistruarit. Me logjikë, pasi s'ke përse të investosh për një diplomë që nuk vlen. Mjafton një rekord, me hapjen e juridikut, ajo degë u dynd nga shefat e

komisariateve apo kursantët e plepave që vrapuan të merrnin diploma në vitet 90. E kështu doli barcaleta “Shkolla e Partisë”.

Njolla si “Shkolla e Partisë” nuk u hoq asnjëherë këto 30 vjet, ku janë ndërruar shumë rektorë. Sot, ka një lëvizje të re.

Profesor Gjuraj, e ka nisur karrierën e tij po në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, madje jo vetëm si pedagog i Sociologjisë,



por edhe si shefi i parë i marrëdhënieve me jashtë, ku në atë kohë universiteti pati kërcimin më të rëndësishëm cilësor. Profesorë të Universitetit të Shkodrës u trajnuan në katedrat më të rëndësishme të Athinës, Romës, Vjenës, e universiteteve më në zë të Evropës, falë marrëdhënieve të reja, programeve të njohura evropiane si Erasmus e të tjerë.

Profesor Gjuraj, më pas ju kushtua diplomacisë, ku ka qenë ambasador në disa vende, por sapo mbylli mandatat diplomatike ju kthye karrierës akademike, ku zëvendësoi Adrian Civicin, Rektor i Universitetit “Evropian të Tiranës”. Një nga universitetet private më proaktiv dhe cilësorë në vend. që ka dhënë një dorë të madhe, kryesisht në mbrojtjen, promovimin e fuqizimin e pozitës së profesoratit, duke mos u bërë asnjëherë me pronarin përpara kolegëve të tij.

Rikthimi i tij në Shkodër, është një



shans i rëndësishëm për ta ndarë “Luigj Gurakuqin” nga një kuvli arsimor province e për ta bërë edhe më të lavdishëm se ILA-ja e kohës. Profesor Gjuraj, ka dijet, shkathtësinë e diplomacinë për ta lidhur me universitetet më të mira të Evropës, e ç' është më e rëndësishmja, për të mos u bërë servil i pushtetit para pedagogëve. Kur nuk e ka bërë te privati, që të heq

vinciale, tribale e religjioze, që sa herë shfaqen, e rrezikojnë Shkodrën të mos bëhet metropol. Shkurt, “Luigj Gurakuqi” nga një universitet province, me Tonin Gjurajn kthehet në Universitet Metropolitan, kosmopolit, e madje edhe ndërkombëtar!

Kush është Prof. Dr. Tonin Gjuraj?

Prof. Dr. Tonin Gjuraj, u lind më 4 Maj 1967, në fshatin Pentar, me origjinë nga fshati Gjuraj i krahinës së Pultit, anëtar i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Fëmijërinë e kaloi në fshatin ku lindi dhe përfundoi shkollën fillore e tetëvjeçare. Në shkollë u shqua për rezultate shumë të larta. Në periudhën 1981-1985, përfundoi shkollën e Mesme Pedagogjike “Shejnaze Juka”, Shkodër.

Në vitet 1985-1989 përfundoi studimet e larta, në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, në degën e gjuhës angleze. Në vitet 1994-1995 vijoi studimet pasuniversitare pranë Universitetit të Evropës Qendrore (CEU), në Departamentin e Sociologjisë dhe Politikës dhe mori gradën “Master of Arts” në Society & Politics, në Pragë, Republika Çeke.

Në vitet 1995-1997, pranë UT-së, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë dhe Sociologjisë, mbrojtëti gradën “Doktor i Shkencave” në Sociologji.

Në vitin 2004, fitoi titullin Profesor i Asociuar, kurse më 28 maj 2014 titullin “Profesor”.

Ka një eksperiencë të gjatë në punë dhe pozicione të ndryshme: ka filluar punën si mësues i gjuhës angleze, 1989-1991, pranë gjimnazit “Asim Vokshi” në Bajram Curri;

Në vitin 1991-1992 mësues i gjuhës angleze, në gjimnazin e Dajçit, Shkodër;

Në vitin 1992-1993, mësues i gjuhës angleze, në shkollën e mesme të Gjuhëve të Huaja “Shejnaze Juka”, Shkodër;

Në vitin 1993-1994, mësues i gjuhës angleze (part-time në kurse të organizuara nga Fondacioni Soros); Në vitin 1995-1996 mësuesdhënës në kuadrin e projektit për edukimin qytetar (CEP-Civic Education Project);

Në vitin 1998 - në vijim lektor i Sociologjisë, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër;

Në vitin 2000 - 2001 mësues i lëndës: Njohuri për Shoqërinë, Gjimnazi Linguist INKUS, Shkodër;

Në vitin 2004 - në vijim lektor, në sociologji, Sociologji Kulturë, Universiteti i Malit të Zi;

Në vitin 2005 - në vijim lektor, Antropologji Kulturore. Dega e Psikologjisë, viti II-të, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”;

Në vitin 2007 e në vijim ka punuar në Universitetin Evropian të Tiranës, duke qenë dekani i parë i Fakultetit të Shkencave Sociale. Aktual-

NGA MANIFESTIMI “DITA E PLISIT” EDICIONI XI

Me 28 korrik u mbajt Dita e Plisit edicioni XI, faza e tretë, u mbajt në Oden e gjeneralëve Shaban e Bedri Shala, në fshatin Gjergjiçë, komuna e Drenasit.

Në orët e hershme të mëngjesit Plisbardashët ia kishin mësy fshatit Gjergjiçë komuna e Drenasit, çdo gjë ishte përgatit për ti prit mysafiret plisbardashë.

Plisbardashët vinin nga të gjitha trevat shqiptare e nga diaspora, të cilët u mirëpritën nga vendasit, me në krye Elmi Shalën, Pasi u vendosen në ambientet e jashtme të odes, në ora 10. 00 sipas skenarit filluan të hyn në odë, duke respektuar moshën e largësinë nga kishin ardhur.

Po sa u vendosen plisbardashët në odë fillon këngë maje krahu (malësorçe) nga rapsodi Nazmi Hajdari.

Ideatori dhe organizatori i manifestimit “Dita e Plisit” e shpall të hapur manifestimin dhe i përshëndet të pranishmit dhe u dëshiron mirëseardhje.

Pastaj plisbardashë i përshëndet dhe u dëshiron mirëseardhje në fshatin Gjergjiçë dhe në komunën e Drenasit, kryetari I komunës Drenas, z. Ramiz Lladovci.

Para plisbardashëve u paraqit I riu Gentian Ramadan Selimi, me një instrumentale me çifteli.

Në vijim, drejtuesi e fton shkrimtarin, poetin e kritikun letrar Prende Buzhala, për ta paraqit temën: “KËSHITU RRINË BASHKË GJITHË POPULLI SHQIPTAR”, ligjërimi u përcoll me vëmendje nga të pranishmit.

Vijojnë rapsodët Naim S. Krasniqi e Sali B. Bytyqi, me këngën e tyre, të cilët u mirëpritën nga të pranishmit.

Drejtuesi e fton Gani Bytyçin, për ta paraqit temën: “DY SIMBOLE TË IDEN-



TITETIT HISTORIK E KOMBËTAR TË ATDHEUT”.

Pastaj vijoi, me këngën e tij artisti, këngëtar i rapsodi Shaqir Cërvadiku.

Shkrimtari e historian, Bedri Tahiri në pamundësi të jetë prezent e kishte dërgua kumtesën e tij në dorëshkrim. Kumtesa e Bedri Tahirit titullohet: “SHKËLQIMI I PLISIT NË LUFTËN E LAVDISHME TË UÇK-së”.

Kishin ardhur nga të gjitha trojet shqiptare, nga Shkupi, Skënder Asani, drejtor në Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptareve në Republikën e Maqedonisë Veriut (pat një fjalë përshëndetëse); publicisti e njeriu i letrave Emin Azemi, si dhe përfaqësues të manifestimeve të plisit nga Tetova, Presheva, Medvegja e nga Tirana Agron Isa Gjedia, Shkodra - Shoqata Atdhetare “Dukagjini”

si shumë herë të tjera mori pjesë me një grup kryesuar nga kryetari Ndue Sanaj, z. Kolë Çardaku, z Lulash Martini dhe Lulash Brigja, e të tjerë.

Drejtuesi, fjalën ia jep Kolonelit të ushtrisë shqiptare, tani në pension z. Ndue Sanaj, kryetar I SHAD në SHkodër.

U ndane disa tituj nderi nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, Shkodër, për disa personaliteteve të

shquara të artit, kulturës, trashëgimisë e letersisë.

Këngëtar i Skënder Hasi u paraqit para të pranishmive me dy këngë kushtuar dëshmorëve të kombit.

Nga drejtuesi u kërkua që ta merr fjalën plisbardhi 87 vjeçar, Mark Pjeter Berisha nga Daberdoli i Klinës.

Me këngë u paraqitet Gentian Ramadan Selimi.

Manifestimi “Dita e Plisit” përmbyllet me këngë nga rapsodët: Rifat Dragaj, Shaqir Cërvadiku, Naim S. Krasniqi e Sali B. Bytyqi dhe Skënder Hasi.

Kur u këndua kënga “Thrret Prizren mori Shkodër” autori I tekstit Sylë Bajrami ishte prezent, I cili edhe ishte I emocionuar.

Grupi përfundoi me këngën “Mora fjalë”. Ideatori e organizatori “Dita e Plisit” falënderoi plisbardashët për pjesëmarrje e mire u takofshim në edicionin e XII në vitin 2025.

Në fund nga i zoti i shtëpisë u shtrua sofra për plisbardashët me ushqime tradicionale.

ISMET KRASNIQI
korrik 2024

ishtë është lektor i lëndëve “Bazat e Diplomacisë” dhe “Diplomaci Publike dhe Ekonomike” në këtë institucion.

Gjatë kësaj periudhë ka punuar në pozicione të ndryshme drejtuese:

Në vitin 1992-1993 drejtor i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Dajç;

Në vitin 1993-1997 dhe 2000-2004, drejtor i zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”;

Në vitin 2003-2006, Kryetar i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zhvillimit pranë Këshillit Bashkiak Shkodër;

Në vitin 2006-2007, Universiteti Evropian i Tiranës, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale;

Në vitin 2007-2009 Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i RSH-së në Shtetin e Izraelit;

Në vitin 2009-2011 Zv/Rektor i Universitetit Evropian të Tiranës;

Në vitin 2011- 2018, Rektor i Universitetit Evropian të Tiranës,

Në vitin 2019 - 2020 Zv/ректор i Universitetit Evropian të Tiranës, për t'u rikthyer përsëri në pozicionin e rektorit në shator 2020 e në vijim.

Prof. Dr. Gjuraraj është nënkryetar i Konferencës së Rektorëve, që prej tetorit të 2020-ës dhe anëtar i Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë.

Tonin Gjuraraj ka kryer një sërë kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit, ndër më të rëndësishmet e të cilave mund të veçojmë:



Me SH. T. Z. Martin Polaschek-Ministër Federal i Arsimit, shkencës dhe kërkimit i Republikës së Austrisë, nëntor 2022

*Trajtime për gjuhët e huaja (anglisht dhe gjermanisht në universitete të njohura), trajtime që lidhen me metodat e mësimdhënies, mbi edukimin qytetar demokratik, kërkim e studim në Sociologji: “Demokracia dhe Feja në Shqipëri”;

*Studime evropiane, hartim kurikule, konferenca ndërkombëtare mbi autonominë universitare, konferencë organizuar nga Shoqata për Studimin e Nacionaliteteve, nxitja e harmonisë ndërfaqetare

në Shqipëri, konferencë për religjionet në Shqipëri, Rrjeti Kotor “Imazhet e njerëzve me fe të ndryshme”, e të tjera.

*Ai ka qenë pjesë e veprimtarive të përmendura në vende të ndryshme si në: Itali, Slloveni, Francë, Mali i Zi, Kosovë, SHBA, Austri, Holandë, Bosnjë & Hercegovina, Poloni, Hungari, Republika Çeke, Norvegji, Izrael, Portugali dhe Spanjë.

Në vijim të ngritjes së tij profesionale, ka kryer:

*Në vitin 1997-1998 Universiteti i Oksfordit, Kolegji St. Anthony, Program Studimi dhe Kërkimi Pasuniversitar në Sociologji nën udhëheqjen shkencore të Prof. Alfred Stepan;

*Në vitin 1997 ka marrë gradën “Doktor i Shkencave” me temën: “Bashkëkzistenca e grupeve të ndryshme fetare në shoqërinë multifetare shqiptare”;

*Me datën 24 korrik 2003 është titulluar “Profesor i Asociuar” nga KKSH-ja,

*Ministria Arsimit dhe Shkencës; 2009 (janar-qershor) Certifikatë Ekzekutive për Shoqërinë, Historinë dhe Politikën Izraelite, në Qendrën Ndërdisciplinore në Herzliya, IDC Herzliya, Lauder School of Government, Diplomacy & Strategy, Tel Aviv, Izrael, në vitin 2014 fituar titullin “Profesor”.

Aktualisht është rektor i Universitetit Evropian të Tiranës, një prej institucioneve private më të mira të arsimit të lartë në vend, akredituar dhe riakredituar së fundi, në korrik të 2022, nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (QAA) në Britaninë e Madhe.

Prrof. Dr. Tonin Gjuraraj, urime e urime! Me faqe të bardhë në detyrën e Rektorit të Universitetit të Shkodrës, i pagëzuar me emrin e madh “Luigj Gurakuqi”

Resaksia e gazetës
“DUKAGJINI”

KËSHITU RRINË BASHKË GJITHË POPULLI SHQIPTAR

(Manifestimi DTA E PLISIT, edicion XI, në Gjergjicë të Drenasit, në e familjes
dhe odës së Gjeneralëve Shaban Shala e Bedri Shala)

Sot, në ambientet e familjes dhe odës së Gjeneralëve Shaban Shala e Bedri Shala, në Gjergjicë të Drenasit, u mbajt manifestimi DITA E PLISIT- faza e dytë (faza e parë për këtë vit ishte mbajtur në Ponorc të Malishevës), nën drejtimin e ideatorit të kësaj veprimtarie, Ismet Krasniqi Lala, aktor. Tubimin e përshëndeti kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Morën pjesë edhe përfaqësues të institucionesh të trashëgimisë, nga Shkupi: Skënder Asani, drejtor në Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptareve në Republikën e Maqedonsë (pat një fjalë përshëndetëse), publicisti e njeru i letrave Emin Azemi, si dhe përfaqësues të manifestimeve të plisit nga Tetova, Presheva, nga Tirana (Agron Gjedia), Shkodra - Shoqata Atdhetare Dukagjini si shumë herë të tjera mori pjesë me një grup kryesuar nga kryetari Ndue Sanaj dhe z.Kolë Çardaku z Lulash Martini dhe Lulash Brigja etj. Kënduan grupe rapsodësh: Shaqir Cërrvadiku, Skënder Hasi, Naim S. Krasniqi e Sali B. Bytyqi, Nazmi Hajdari dhe rapsodi i ri Gentian Selimi.

Me kumtesa rreth temës bosht "PLISI, KULLA DHE REZISTENCA LUF-TARAKE", u paraqitën Prend Buzhala e Gani Bytyçi.

Shoqata Atdhetare Dukagjini me këtë rast shpërndau disa vlerësime dhe mirënjohje për personalitete të njohur të luftës dhe Paqes. Fjalë përshëndetëse patën dhe mërgimtarë dhe miqtë të tjerë. Po ashtu, mirënjohje post mortum ndau edhe organizator i manifestimit "DITA E PLISIT", për Zenel Berishën, Mësuesi dardan Hamdi Kurti e të tjerë.

Karakteristike, kësaj radhe, ishte pjesëmarrja e disa pleqve të moshuar, të cilët e kanë bartur plisin prej rinisi së tyre, si plaku 87-vjeçar Mark Pjetër Berisha nga Dobërdoli i Klinëps apo Haki Qerim Samahodaj, prind një dëshmorë nga fshati Krajk (Has).

Në fund të manifestimit, kur rapsodët po këndonin së bashku këngën "Thërret Prizreni mori Shkodër", dretuesi Ismet Krasniqi njoftoi se pakkush e di që tekstin e kësaj kënge e ka shkruar poeti drenicas që jeton në mërgatë, Sylë Bajrami. Ashtu, si u gjendën bashkë në këtë manifestim, ashtu u përmyll ky manifestim me fuqinë shprehëse të këngës "Thërret Prizreni mori Shkodër". Rapsodët dhuruan një çast këndimi tejet frymëzues.

THËRRET PRIZRENI MOR SHKODËR

Hej,
Thërret Prizreni mori Shkodër
Hajde të rrijmë se të kam motër
Merre Durrësin dhe Tiranën
Se na kështu e gëzojna nënën



Unë thërras Pejë edhe Gjakovë
Drenicë, Llap edhe Rugovë
Vjen Deçani e Mitrovica
Kaçaniku e Kamenica
Vjen Gjilani e Prishtina
Ferizaji edhe Klina
Oh, në këtë kala së bashku të rrina
Hej,
Kur të vini mos harroni
Edhe Krujë këtu të ma ftoni
Çoni lajm në Gjirokastrë
Tepelenë e Mallakastër
Has, Mirditë, Kuksin me thirrë
Thirre Korçën o me rrethinë
Thërras Tetovën e Gostivarin
Thërras Ulqinin e Tivarin
Bujanovci, vjen Presheva
Suhareka e Malisheva
O tën Gollaku e Podujeva
Hej,

Kam thirrë Plavë
Kam thirrë Guci
Hot e Grudë edhe Malësi
Kam thirrë Dibrën, Ohrin, Strugën
Merre Lezhën edhe Pukën
Vjen Çamëria, vjen Janinë

O lum na lum së bashku do rrina
Manastiri ka çu fjalë
Gjithsesi unë kam me ardhë
Gjithsesi unë kam me ardhë
O se për Korçë malli më ka marrë
Po ni besë ka thanë e ki
O herdokur te ju do vij
Hej,
Kur të vini dorë për dorë
Mos harroni të shkoni në Vlorë
Çonja Vlorës një porosi
Një flamur le ta mbajë në gji
Të gjithë vllazën edhe motra
Ejani këtu po na thërret votra
Një kunorë bashkë ta qëndisim
Një flamur pa yll ta ngrisim
Le të dëgjojë sot bota mbarë
Hej, kështu rrinë bashkë o
Gjithë populli shqiptar

Është një këngë jashtëzakonisht e popullarizuar shqiptare, që përmban motive patriotike dhe paraqet ndjesitë e bashkimit dhe unitetit kombëtar ndërmjet shqiptarëve nga rajone të ndryshme. Kënga bën një thirrje të fortë për bashkim

të të gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga ndarjet gjeografike dhe politike. Prizreni, një qytet i njohur për historinë e tij patriotike, simbolizon thirrjen për bashkim dhe solidaritet. Me këngën, thuhet se çdo qytet shqiptar është i mirëpritur dhe se të gjithë shqiptarët janë të ftuar të bashkohen për të festuar dhe marrë pjesë në një identitet të përbashkët.

Kënga fillon me një thirrje për bashkim, duke përfshirë qytete dhe rajone të ndryshme nga Shqipëria, Kosova dhe viset tjera etnike dhe shpreh dëshirën për bashkim të të gjitha territoreve dhe qyteteve shqiptare. Në strofën e dytë, theksohet rëndësia e përfshirjes së të gjitha zonave shqiptare, duke përfshirë edhe ato që ndodhen jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme, si Tetova dhe Ulqini. Kjo thirrje tregon një ndjenjë të fortë të lidhjes dhe solidaritetit ndërmjet shqiptarëve, pavarësisht nga vendndodhja e tyre.

Strofat e mëtejshme bëjnë thirrje për përfshirjen e qyteteve të ndryshme që ndodhen në vende të ndryshme, duke përfshirë edhe Çamërinë dhe Janinën. Kënga thekson një ndjenjë të thellë patriotike dhe dëshirën për të bashkuar të gjitha territoret shqiptare në një festë të madhe.

Pjesa e fundit e këngës bën thirrje për ngritjen e një flamuri dhe simbolikën e bashkimit. Thirrja për të ngritur një flamur pa yll, që simbolizon një identitet të bashkuar dhe të fortë, është një akt i rëndësishëm i identifikimit dhe unitetit kombëtar.

Kënga "Thërret Prizreni mori Shkodër" është shprehje e fortë e dëshirës për bashkim dhe unitet ndërmjet shqiptarëve.

Kënga simbolizon një aspiratë për një ndjenjë të përbashkët për ruajtjen dhe festimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të shqiptarëve.

Le të dëgjojë sot bota mbarë
Hej, kështu rrinë bashkë o
Gjithë populli shqiptar

Këto tri vargje përmbledhin shumë nga ideat e gjakimet shqiptare. Ajo thekson dëshirën për që të gjithë bota të dëgjojë dhe të njohë unitetin dhe forcën e popullit shqiptar. Mesazhi është se shqiptarët, duke qëndruar bashkë, krijojnë një forcë dhe një zë të fuqishëm. Gjithashtu shprehet një ndjenjë krenarie për identitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet shqiptarëve. Duke u bashkuar, shqiptarët e tregojnë forcën e tyre dhe dëshmuar se ndarjet e mëparshme nuk janë të pafundme, dhe se identiteti i përbashkët është më i fortë dhe më i rëndësishëm.

Prend BUZHALA
28 korrik 2024

Të mos e çnderojmë Plisin e Bardhë!

*Fjala e rastit, e NDUE SANAJ,
në manifestimin "Dita e Plisit",
me 28 korrik 2024*

Përshëndetje pjesëmarrës!

Përshëndetje Katërmosketjerët!

Përshëndetje Kryemosketjeri, aktori Ismet Krasniqi-Lala, Kryeorganizatori i këtij Manifestimi tashmë tradicional dhe që përbën edicionin e XI të Ditës së Plisit. Këta katër intelektual, krijues, artiste, atdhetarë të vendosur na çuan në të gjitha kullat e dhomat ku janë mbledhur burrat e kombit shqiptar, që kanë kuvenduar e kanë marre vendime për fatet e kombit tonë, të cilët në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ju shpreh mirënjohjen më të thellë për punën që kanë bërë.

Plisi i Bardhe tashmë është nisur për në UNESCO, që të jetë pjesë përbërëse e ruajtjes së kulturës botërore!

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe e grupit përfaqësues të saj në këtë Manifestim, të z. Kole Çardaku-N/ Kryetari i saj, biznesmenit e aktivistit të saj, z. Lulash Martini, të poetit tashmë të njohur z. Lulash Brigja, mirë se u gjetëm dhe të gjithëve na u priftë e mbara në realizimin e misionit të këtij Manifestimi të Ditës së Plisit të Bardhë.

Këtu ka publicist, poet e shkrimtar, madje dhe historian të fushës etnografike shqiptare, që për këtë çështje dinë më shumë se unë, por aq sa kam lexuar, dua të shtroj një çështje, që nuk e duron Plisi i Bardhe, i cili që herën e pare, që është vu në kokën e pellazgut, në kokën e Ilirianit e në kokën e shqiptarit, madje dhe të Papës, është vu i bardhe dhe pa asnjë shenjë mbi këtë bardhësi dhe deri më sot ky Plis i Bardhe, apo kjo kësule e bardhe ka përfaqësuar shqiptarin

Të nderuar e theksoj këtë problem dhe e shoqëroj me këto foto, për të bere një pyetje: Ata nuk dinin të venin në Plis të Bardhe simbole të tjera, qoftë dhe kombëtare? Po, e dinin, po dinin dhe këtë, se Plisi i Bardhe nuk pranon simbol tjetër qoftë dhe kombëtare ...

Më vjen jo mirë, që në këtë Manifestim marrin pjesë me Plis të Bardhe të cenuar nderin e tij ... , të cilët nuk duhet të jene pjesë e këtij manifestimi

Në Manifestimet e para asnjë pjesëmarrës Plisë Bardhë nuk e kanë shkel nderin e tij dhe për çudi, disa kanë kohë që kane fillua me çnderua Plisin e Bardhë, që nuk të lejon ta çnderosh ...

E ndjeje veten jo mirë, kur nepër stadione, koncerte, manifestime e deri në lëvizjen e lirë nëpër qytet, në mjedise të ndryshme shoh shqiptar, të cilët kanë çnderua Plisin e Bardhë, simbolin e hershem të shqiptarisë, duke e quajtur veten më modern apo më shqiptar

Nuk kam ndërmend të cenoj askujt nderin e tij, por askush të mos bëj përpjekje qofte dhe pa dashje të çnderojnë Plisin e Bardhe

Të nderuar!

Kryemosketjeri i jone, Ismet Krasniqi-Lala, me ftesën që na ka dërguar, jo vetëm, na ka nderuar, por na ka futur dhe në

punë

Së pari, për të marre pjesë në këtë Manifestim, duke u bërë pjesë e tij dhe që është nderim për ne

Së dyti, futi në punë Kryesine e Shoqatës, me propozimet e tij dhe në mbledhjen e saj, me datën 20 korrik 2024, me vendim nr. 287, miratoj propozimet e tij:

a- Çifti Fehmi e Xheve Lladrovci, të nderohet me titullin "Mirënjohja Mehmet Shpendi", pas vdekjes, me motivacion: "Për sakrificë të madhe, duke dhanë jetën për liri çifti Fehmi e Xheve Lladrovci, të cilët ranë heroikisht në luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Jeta dhe vepra e tyre, u bënë simbol i sakrificës së dashurisë për Atdhe. Lavdi!"

b- Gjeneral Shaban Shala, të nderohet me titullin "Mirënjohja Mehmet Shpendi", pas vdekjes,

me motivacion: "Për kontribut të shquar për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb; për trimëri të spikatur në drejtimin strategjik në funksionin e komandantit, strateg i suksesshëm i UÇK-së gjate luftës për liri. Jeta dhe emri i tij frymëzim dhe krenari për brezat. Lavdi!"

c- Habib Morina, të nderohet me titullin "Mirënjohja Mehmet Shpendi", pas vdekjes, me

motivacion: "Për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së, pjesëmarrës aktiv dhe komandant i nderuar; shembull frymëzimi në detyrën e komandantit të parë i stacionit të Policisë në Klinë, në Kosovën e lirë. Do ta kujtojmë gjithmonë me nderime për guxim, trimëri dhe aftësi drejtuese."

d- Ymer Elshani, të nderohet me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", pas vdekjes, me motivacion: "Ju dhe familja juaj mbeteni simbol krenarie i luftës Çlirimtare për liri; për kontributin e dhanë në fushën e shkollimit, letërsisë dhe rezistencës kundër okupatorit serb. Kjo familje u flijua nga barbaria serbe, me gjyshin, babën, nenën, dy vëllezërit e pjesëtarët e tjerë të familjes. Lavdi!"

e- Marin Sopi, të nderohet me titullin "Mirënjohja Mësuese Kush Micja", me motivacion: "Për kontributin tuaj të shkëlqyer si reporter dhe luftëtar i shquar gjatë sakrificës kombëtare për liri. Për punën tuaj shumëvjeçare si atdhetar i flaktë dhe mësimdhënës shembullor në edukimin e brezave"

f- Rapsodin Nazmi Hajdari, të nderohet me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin dhe mesazhin të shkëlqyer të dhanë si rapsod në veprimtaritë kulturore në nivel kombëtare, pjesëmarrës i nderuar në manifestimet "Dita e Plisit" nder vite".

g- Kolonel Et' hem Bardhi, të nderohet me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Në moshën më të bukur të rinisë tuaj ja dhuruat një pjesë të saj banoreve të Shkodrës, dukagjinat e bregabunas, të cilët ju respektuan, sepse i respektuat, aq sa edhe sot, pas shumë vitesh, që jeni larguar ju kujtojnë me respekt e dashuri. Kuadro si ju i bëjnë vend vetes, por dhe mbeten të gdhendur në mendjet dhe zemrat e tyre.

Faleminderit për punën dhe përkushtimin tuaj, faleminderit për lidhjen e qëndrueshme me ne banoret e Shkodrës, të cilët, në veçanti brezi me të cilët punuat, do ta kujtojnë pejanin përherë me shumë respekt".

h- Komuna Drenas, të nderohet me dhurimin e Logut të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me motivacion: "Për mbështetjen e vijueshme të veprimtarive kulturore, artistike me karakter kombëtar, në veçanti të shoqërisë civile, për të realizuar misionin e tyre. Komuna e Drenasit simbol i luftës për liri".

Miq të nderuar, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", e mbështet propozimin, që Dita e Plisit të jetë një ditë veçantë për kombin tonë, feste kombëtare.

Miq të nderuar ju faleminderit për kohën që më kushtua dhe mirë u takofshim në Manifestime të tjera.

Poeti Lulash Brigja, me përfundimin e këtij Manifestimi do të komentonte:

"Sot u mbajt manifestimi "Dita e Plisit – 2024", një veprimtari kulturore e artistike mbarë kombëtare. Manifestimi mbajt në Oden e Gjeneral Shaban Shalës në fshatin Gjergjicë, Komuna Drenas.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" si shumë herë të tjera mori pjesë me një grup

perfaqesues i kryesuar nga kryetari Ndue Sanaj, z. Kolë Çardaku, z. Lulash Martini dhe Lulash Brigja. Faleminderit për mikpritjen organizatorëve të "Dites së Plisit, z Ismet Krasniqi - Lala dhe grupit të tij.

Në një kohë të nxehte dhe me shumë miq u paraqiten ligjerime nga z. Gani Bytyçi, z. Prend Buzhala, të nderthurura, me rapsod dhe këngëtar të njohur të grupit folklorik të Kosovës, duke nisur me Shaqir Cërravadiku, Skënder Hasi, Naim S. Krasniqi e Sali B. Bytyqi, Nazmi Hajdari dhe rapsodi i ri Gentian Selimi,

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me këtë rast shpërndau disa tituj nderi për presonalitete të njohur të luftës dhe Paqës.

Kronika e kesaj veprimtarie, është e gjerë, por sonte po mjaftohemi me një Faleminderit për organizatoret dhe te zotët e shtëpisë..

Normalisht edhe disa foto nga kjo ditë e bukur!

Sa me shumë të takohemi dhe te promovojme vlerat tona kombëtare aq me bukur është!"

Mundësoj marrjen pjesë në këtë veprimtari, z. Gjergj Leqejza e z. Lulash Martini, të i urojmë me shprehjen popullore: "Paçi e dhënçil!"



Drejtimi bashkëkohor i shkollës, kërkesë parësore për realizimin e misionit të saj

Në prag të fillimit të Ri mësimor 2024-2025



Shkruar nga: Fran Gjoka

Drejtimi shkollës është parësor, jo vetëm për rëndësinë dhe peshën që ka një drejtues, por sepse nga mënyra e drejtimit dhe menaxhimit të punëve drejtuese të shkollës, kushtëzohen dhe çlirimi i energjive pozitive, i kapaciteteve të mendjes dhe të eksperiencave, të mësuesve tanë të përkushtuar ndaj shkollimit. Rrjedhat e zhvillimeve njohja e Evropës dhe e praktikave që ato përdorin në drejtimin e shkollës, janë sigurisht një mësim i madh për ne, por të zbatuar, ato në kushtet konkrete të shkollave tona, natyrisht që kërkojnë vëmendjen e duhur, kujdes dhe preokupacion të veçantë.

Një drejtor i sotëm, në radhë të parë kërkohej të jetë i përgatitur mirë nga ana profesionale e shkencore, kërkohej të jetë një drejtues i kualifikuar i drejtimit dhe organizimit të punëve, por edhe një njeri që di të njohë thellë shpirtin njerëzor të fëmijëve, nxënësve të shkollës, që ai drejtoi, por edhe të kolegëve të tij, mësuesve, të cilët, janë pikërisht ata, që do zbatojnë idetë më të përparuara dhe do të bëjnë të përvetësueshme tekstet përmbajtjet e tyre dhe programin mësimor edukativ të shkollave tona. Ka kohë që është shtruar nevoja për të pasur një drejtor efektiv, një shkollë që të përmbush kërkesat e interesat e nxënësve e të bashkësisë prindëror, por problemet nuk duhen pare e trajtuar thjeshtë si vendi ku përcaktohen detyra dhe nxirren përgjegjësi, por edhe si forma ku merret e jepet eksperiencë e përparuar dhe ku ballafaqohen ide e mendime të kohës. Ka ardhur koha të kërkojmë ata drejtor shkollash që janë korrekt me veten dhe me të tjerët, që nuk njohin cmirën dhe hakmarrrjen, që i shoqëron fjala e ngrohtë dhe e mençur, prapa së cilës ta ndjek vetëm mirësinë dhe aspak mendimet keqdashëse të tij. Ç'është e vërteta detyra e drejtuesit të shkollës është një barrë jo e lehtë, por ka edhe nga ata që e kanë quajtur "vend punësimi" dhe për këtë arsye rezultatet e shkollës, puna mësimore dhe ajo edukative janë luhatur sa për të qenë shkollë. Dihet se, në shkollat tona problemet e shqetësimit janë evidente, por rezulton se sa me i interesuar të jetë mësuesi aq më pak probleme ka shkolla e tij. Deri tani strukturat tona të shkollimit kanë synuar të zgjedhin deri diku, në detyrën e drejtorit mësuesin më të mirë të shkollës, por shpesh kjo nuk ka qenë e

mjaftueshme, pasi drejtuesi i një kolektivi mësimor që e sheh veten të barabartë me kolegët, duhet të manifestojë disa cilësi të tjera njerëzore që ta dallojë nga kolektivi.

Një drejtor ose një individ që ëndërron të bëhet i tillë duhet të japë disa garanci në përpjekjet e tij për çuarjen përpara të reformës e shprehur, kjo në plotësimin e disa kushteve, ndër të cilët po përmendim:

*Të jetë i pranueshëm nga kolektivi i mësuesve dhe i nxënësve e punonjësve të tjerë, nga bashkësia ku vepron shkolla dhe mjedisi socialpedagogjik në tërësi. Të jetë së paku i shkolluar dhe i kualifikuar në nivelin e mësuesve më të dalluar të shkollës.

*Një drejtues i pranueshëm duhet të ketë aftësi, që të krijojë klimë pune normale në shkollë, të dijë t'i vërë në punë mësuesit më të mirë, më të butë, jo me urdhra, të bërtitura dhe masa ndëshkimore, ndonëse edhe këto të fundit duhen për ata që abuzojnë hera – herës, Ai duhet të bëjë ç'është e mundur që të njohë nga afër përvojën e secilit, shkallën e ndërgjegjes, sistemin e punës, tipin e psikologjinë, problemet shëndetësore dhe ato familjare, që mund të ketë dhe të bëjë maksimumin për t'i zbutur ato. Me grupin e mësuesve duhet patjetër të bëjë diferencime, duke i grupuar sipas aftësisë dhe efektivitetit të tyre.

*Nëse drejtori e shikon se fjala dhe këshilla e tij nuk bën efekt, atëherë "shtrëngoj" atë në punë. Rruga më e mirë për t'a bërë këtë është kontrolli sistematik, por jo i paragjykuar, lënia e detyrave dhe zbatimi i tyre.

*Me mësues më me pak përvojë pune në arsim dhe ata të rinj duhen "marre për dore", në kuptimin më të mirë të fjalës. Ky grup duhet të jetë objekt i veçantë i punës ndihmëse e kontrolluese, trajnuese e kualifikuese të drejtorisë së shkollës. Për këtë kategori mësuesish të bëhet ç'është e mundur që ata të bëhen specialistë në kuptimin e vërtetë të fjalës për tre - katër vite pune. Nëse brenda kësaj kohe nuk bëhen të tillë, si rregull, nuk arrijnë t'ia dalin mbanë asnjëherë. Kërkesa kryesore ndaj tyre është të punuarit dhe të komunikuarit me shumë takt e durim dhe sa më shumë e kualifikuar. Mësues të tillë duhen motivuar, për çdo përpjekje pozitive dhe arritje sado e vogël të jete ajo. Interesi i së ardhmes së shkollimit është që ata të futen në rrjedhën e punës e të garantojnë suksesin.

Pavarësisht se sot puna e mësuesit, është disi më pak stresuese, përsëri ai vijon të përjetojë ankth, frikë e tension, të shkaktohet shpesh herë nga metoda autoritariste dhe burokratike e drejtuesit, i cili defektet e tij si mësues, dhe aq më tepër si drejtues, përpigjet t'i mbulojë me pushtetin e karriges, që padrejtësisht ia kanë dhanë të tjerët.

*Drejtori dhe zëvendësit e tij nëse e kanë formim e duhur shkencor, psikosocial e metodik dhe kanë një përvojë pune të caktuar krijojnë mjedise pune e bashkëpunim të frytshëm mes palëve. i fusin me të mirë në punë mësuesit, dinë se çfarë të japin dhe çfarë të kontrollojnë, njohin nga

afër psikologjinë dhe shqetësimet individuale e familjare që ata mund të kenë e të tjerë.

*Drejtesi i mirë dhe i aftë duhet të dalë mbi palët e konfliktuara dhe vogëlsirave, ta vlerësojë situatën që mund të krijohet në shkollë apo në bashkësi por të mos e dramatizojë. Të jetë asnjans në vendimet që merr dhe në punë e sipër të krijojë mendimin tek punonjësit se për te në punë të gjithë janë të barabartë.

*Në kontroll shkohet disi i përgatitur dhe me mendimin jo vetëm për t'i mësuar të tjerët, por edhe për të mësuar prej tyre. Kush ecën me mendimin se mësuesit e formuar dhe me përvojë janë burime dijeshe edhe për kontrolluesin, ai ka të drejtë të pretendojë se ka të dhëna, për t'u bërë drejtues i kualifikuar. Një drejtues me vizion të gjerë nuk duhet të jetë kurrë komandues dhe diktues, por rekomandues dhe sugjerues, nxitës i vërtetë i debatit shkencor e didaktik, psikosocial dhe pedagogjik. Vetëm kur të heqim dorë nga preferencat partiake, nepotike dhe servilizmit në punën me kuadrin në arsim dhe do të orientohejmë vetëm nga "hakmarrrja" profesionale, do të garantojmë disi realizimin me sukses të reformës dhe plotësimin e standardeve

Ne, punonjësit e arsimit, i njohim vështirësitë specifike të drejtimit, por edhe nuk duhet t'i dramatizojmë ato. Vështirësitë teknike të pajisjes dhe kompletimit më bazën e nevojshme material - teknike, vijnë duke u plotësuar e perfeksionuar nga dita në ditë; raporti i numrit të mësuesve dhe nxënësve po shkon drejt standardeve, që ka edhe Evropa; ndërkohë, që, mjetet e informacionit masiv shkencor, internet dhe përdorimi i kompjuterit, tabelat elektronike dhe ajo bazë e fuqishme materiale bashkëkohore, po sigurohet me prioritet nga dita në ditë dhe po bëhet pjesë përbërëse e zhvillimit të orëve mësimore, në shkollat tona. Çështja, më shumë mbetet të krijimi i mentaliteteve të reja, i atyre mentaliteteve të përparuara, nga e cila udhëhiqet i gjithë procesi i zhvillimit në shkollë, gjë që do të thotë: Mësues të përgatitur, mjaft mirë nga ana pedagogjike dhe shkencore; drejtues të aftë si profesionistë dhe si drejtues; prindër që ta ndjejnë shkollën si të tyre; një bashkësi, sa më aktiv dhe efektiv, që t'i qëndrojnë afër shkollës, sepse kështu ai i qëndron pranë fëmijëve, nxënësve tanë, qofshin ata në ciklin e ulët, ashtu dhe adoleshentëve në shkollat e mesme. Pra, secili prej nesh, ta konsiderojë si ndër detyrat tona parësore krijimin dhe ngulitjen e një botëkuptimi bashkëkohor, për shkollimin dhe arsimimin, që t'i përgjigjemi si sfidave që kërkon vetë zhvillimi arsimor i vendit dhe i shoqërisë sonë, ashtu dhe kërkesave e detyrave, që ndjejnë brenda vetes për t'u bërë plotësisht dhe pa asnjë mangësi, pjesë e zhvillimeve dhe kërkesave të reja bashkëkohore, që t'i përgjigjemi në çdo hap ndryshimeve reformuese e strukturore, por edhe të hyjmë me dinjitet të lartë në Evropë, ashtu si edhe

e meritojmë. Të bëjmë që punët të na ecin sa më mbarë, duke praktikuar dhe aplikuar format dhe metodat më të mira dhe më të avancuara shkencore. E dimë se nxënësi shikon mësuesin në sy dhe ai e dëgjon dhe e respekton fjalën e tij, por në klasa më të larta, shpesh herë ndodh që, nxënësi e ve përpara provave dhe vështirësive mësuesin, prandaj, ai, në radhë të parë duhet ta ngrejë vetveten në lartësinë e detyrës së tij, profesionalisht dhe shkencërisht. Natyrisht, që po aq, në mos më shumë, kjo është një kërkesë për drejtuesit e shkollave dhe të arsimit në rang rrethi e qarku. Në krye të shkollës, të jetë një drejtues, që në radhë të parë të jetë mësuesi më i mirë, por, ai, të ketë edhe disa cilësi vetjake, origjinale e drejtuese, të cilat nuk lindin vetvetiu, por kërkojnë studim, dije, vëmendje dhe kulturim të vijueshëm. Mbase, do të ishte i udhës aplikimi i idesë së përgatitjes së drejtuesve në shkolla apo kurse të veçanta, që ata të marrin njohuri nga bota dhe të jenë në gjendje t'i aplikojnë ato në praktikë. Ndërkohë, kjo bën që të zbulohen më të mirët, si mësues e drejtues, ata që janë në gjendje t'u përgjigjen suksesshëm sfidave të kohës dhe të zhvillimit. Kualifikimet e vijueshëm, që ne organizojmë si drejtori Qarku apo rrethi, me drejtues e mësues, na bindin për domosdoshmërinë e aftësisë dhe kualifikimit të mëtjetshëm të drejtimit dhe menaxhimit të shkollës. Kështu, ne mendojmë për fëmijët, që janë jo vetëm e ardhmja, por në radhë të parë, ata janë e sotmja. E sotmja, kur ne duhet të punojmë çdo orë, çdo ditë e javë me ta, duke zbatuar ato forma dhe metoda frytdhënëse, që japin rezultatet më të mira.

Duke ndihmuar shkollën, ndihmojmë të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Vitet ikin si pa u ndjerë, brezat ua lënë radhën njëri-tjetrit, por të gjithë njerëzit, që nga ai qytetari i thjeshtë e gjer tek shkencëtari, krijuesi, artisti, politikani, burrat e shtetit, ministra, kryeministra dhe presidentë, të gjithë, kanë qenë dikur në bankat e shkollës, "kanë pasur mësuesit dhe drejtuesit, që me siguri i kujtojnë" dhe i përmendin shpesh në biseda. Por, edhe kur nuk i përmendin, ata nuk mund të shkëputen nga shkolla e tyre. Ato janë shkrirë brenda qenies së gjithsecilit dhe janë bërë pjesë e identitetit, të stilit dhe personalitetit.

Fjala që dëgjon shpesh se mësuesi konsiderohet si "prind i dytë", ka pikërisht këtë domethënie të madhe. Nëse mëma e lind, e ushqen fëmijën me qumësht dhe ushqim të përditshëm, që ai të rritet i shëndetshëm, mësuesi e "ushqen" me dije e kulturë, që ai të bëhet i ditur dhe i mençur, që të njohë botën ku jeton, t'i japë kuptim jetës, të mos vegjetojë dhe të mos kalojë pa lënë gjurmë e pa u ndjerë. Është e njohur sentenca se, megjithëse bota shkon përpara, fëmijët dhe të rinjtë ia nisin nga fillimi. Dhe, për këtë jemi ne, që, më sa mundim, t'u ndriçojmë atyre rrugët e dijeve dhe të jetës, ti ndihmojmë, që të ecin me hapin dhe ritmin e kohës.

Bashkim Artistësh dhe Trojesh Shqiptare në skenën e një Festivali

Festivali i përvitshëm Shqiptar në Miçigan, pasqyrë e shkëlqyer e një bashkësie të bashkuar dhe patriot.

Ky festival, siç përcaktohet edhe në nëntitullin e këtij shkrimi, është rezultat i një pune të pandërprerë, i një kontributi të vijueshëm, ku të gjithë së bashku bëhen pjesë dhe vlerë e një ngjarje, që ka një mision të shenjtë: Ruajtjen dhe trashëgiminë e gjuhës dhe të traditave të bukura shqiptare.

Pjesëmarrja fizikisht, natyrisht dhe emocionalisht në këtë festival, të krijon idenë se këtu vetëm toka është amerikane e çdo gjë tjetër thellësisht shqiptare.

*"Kjoft mallkue, njaj bir Shqyptari,
Që këtë gjuhë të Perëndis',
Trashigim, që na la i Pari,
Trashigim s' ia len ai fmis"*

Festivali organizohet për çdo vit, më 4 korrik në Miçigan nën kujdesin e Kishës së Shën Palit me titullar Dom Fred Kalaj.

Unë isha i ftuar prej njërit nga personalitetet e kësaj bashkësie, si dashamirës dhe përçues i vlerave shqiptare në Amerikën e largët, por dhe si një nga mundësorët e këtij Festivali. Isha pra i ftuar nga z. Peti Camaj, malësori dhe atdhetari i njohur jo vetëm si një biznesmen i shquar, por edhe si krijues i një "Mecenati" që ka qenë gjithmonë një shtëpi e madhe dhe bujare për të gjithë artistët e botës shqiptare.

Ishte pra, pikërisht ky burrë i nderuar që mundësoi që televizioni Kultura Shqiptare ACTV New York, si dhe RTSH, të jenë me kamerën e tyre prezent në një festë të madhe të Bashkësisë Shqiptare në Amerikë, për ta përcjellë atë dhe për t'i treguar shqiptarëve kudo që jetojnë, se ka ardhur dita për t'u prezantuar në botë si një komb i lashtë, i ri dhe gjithmonë i bashkuar.

Kisha e Shën Palit i uroi mirë se ardhjen të gjithë Diasporës së Miçiganit, grupeve mike nga SHBA-ja dhe Canada-ja.

Tridhjetë e tre vite pune, mund me zemër t' bardhë e plot krenari, për këtë ngjarje kaq të madh artistike e kulturore.

Ky festival, është i 33-ti, por është më i miri, më i bukur, me gjithëpërfshirësi dhe i mirëorganizuar. Ky festival është "qershia mbi tortë" e të gjitha festivaleve të Kishës së Shën Palit dhe të gjitha organizimeve masive shqiptare në Diasporë.

Në këtë Festival u bë një bashkim Kombëtar në Diasporë, bazuar mbi historinë, vlerat, traditat, gjuhën dhe kulturën mijëra-vjeçare shqiptare.

Ky Festival shënon fillimin e një lëvizjeje shqiptare, e një ringjalljeje Kombëtare për rikthimin e shqiptarëve në identitet. Meritat i shkojnë Kishës Shën Palit, organizatorëve që tashmë dihen, prindërve dhe fëmijëve të tyre të talentuar e rinisë së mrekullueshme shqiptare.

Si asnjëherë tjetër, këtë radhë numri i grupeve dhe artistëve pjesëmarrës ishte më i gjerë gjeografikisht, duke sjellë vlera tradicionale nga të gjitha trevat shqiptare, në trojet amtare, por dhe në Bashkësinë

Shqiptar në SHBA.

E tillë ishte pjesëmarrja për herë të parë në Miçigan e Shoqatës Kulturore "Xhubleta e Alpeve Shqiptare" me kryetare themeluesen e saj, znj. Rita Kalaj



Shkurtaj. Ajo ishte e ftuar dhe mori pjesë në Festivalin "Xhubleta" të organizuar nga Kisha e Shën Palit. Si bijë e Kastratit dhe duke njohur vlerat e kontributet e saj në ruajtjen, trashëgiminë e cilësive identitare malësore të xhubletës dhe rolin e Ritës në futjen e Xhubletës dhe dije-bërjen e saj në UNESCO, Znj. Rita Shkurtaj u ftua dhe u prit në një takim me Kryesinë e Shoqatës "Kastrati".

Morën pjesë kryetari i Shoqatës "Kastrati", z. Valentin Lumaj, sekretari Ben Burgaj, si dhe anëtarët Pjerin Prekaj dhe Prel Popaj. Takimi shkoi në mënyrë vëllezërore, u trajtuan disa nga vlerat e tradi-

tave të Malësisë së Madhe, si dhe u hodhën ide për bashkëpunim mes Shoqatës "Kastrati" dhe Shoqatës "Xhubleta e Alpeve Shqiptare". Pjesëmarrësit i uruan Znj. Rita Kalaj Shkurtaj, qëndrim të këndshëm



në Amerikë, rrugë të mbarë në Malësi dhe suksese në punën e saj të çmueshme!

Një takim me një drekë mirëseardhjeje për Kryetaren e Shoqatës Kulturore "Xhubleta e Alpeve Shqiptare" znj. Rita Kalaj Shkurtaj, rezervoi në Miçigan edhe patrioti i shquar Ndue Ftoni, Kryetar i Shoqatës "Dukagjini" në Detroit. Në këtë takim u fol më shumë mirënjohje për punën, për dijebërjen dhe vlerat e xhubletës, e të tjera.

"Ndihej me lumtur dhe fort e nderuar si motër mes vëllezërve kastratas, tha në falënderimin e saj zonja Rita Kalaj Shkurtaj, sepse falë tyre u mundësua edhe ud-

hëtimi e pjesëmarrja ime në manifestimin kulturor kushtuar XHUBLETËS, për çka i falënderoj me zemër të gjithë emër për emër, Pjerin Prekaj, Valentin Lumaj, Prel Popaj, Beni Burgaj, Ndoc Lumaj, Kole Burgaj, Sokol Kalaj, Sander Kalaj, Lulzim Popaj dhe Ylli Gilaj.

Takim i rëndësishëm së veçantë, për të cilin së afërmi do bëj një përshkrim për gjithçka që lidhet me vlerat dhe kontributin e Shoqatës "Kastrati" këtu në Miçigan e në vendlindje.

Krenare për këta vëllezër e bij të Kastratit, që me punë e vullnet të mirë po lojtojnë për të përndritur vlerat e Kombit, për të ruajtur gjuhën e traditat e malësorit. Krenare pafund, që edhe pse kanë emigruar të ndarë rrugëve të botës në kërkim të një jete më të mirë për familjen e tyre, janë bashkuar e kanë krijuar me unitet e dashni vëllazërore këtë vatër shpirtërore pranë Kishës "Zoja Pajtores" në Miçigan". Prezent në këtë ngjarje ishte edhe kryetarja e shoqatës "Xhubleta e Malësisë" zonja Shaqe Dushaj.

Siç theksuam edhe më lart numri i grupeve pjesëmarrëse këtë vit ishte më i madh dhe e ndjejmë për detyrë t'i publikojmë në këtë shkrim:

*GGK është grupi që mban emrin e Heroit tonë Kombëtar "Gjergj Kastrioti" dhe drejtohet nga koreografia e mirënjohur Joli Agolli Paparisto. Ky është Grupi i Valleve të Kishës së Shën Palit.

Ky grup tri herë pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Gjirokastër dhe është Ambasador i përçimit dhe ruajtjes së Traditës, Artit dhe Kulturës Shqiptare në SHBA, mori pjesë dhe këtë vit, si çdo vit në Festivalin e 33-të Shqiptar!

*Valltarët e Ansambli Autokton "Rugova", të ardhura nga New Yorku, si dhe ata të grupit "Shqiponat e vogla" nga Kanada nën drejtimin e koreografit të mirënjohur Ramazan Këllezi, nën moton Jug e Veri, ndezën skenën e festivalit me valltare të veshura me kostumin popullor të Dardhës së Korçës dhe xhubletën e çikave malësore.

*Me një performancë të shkëlqyer erdhën në festival edhe Grupi i Valleve "Illyrians" i Kishës Zoja Pajtores Miçigan,

*Shoqëria Kulturore Artistike "Rapsha" në mërgim,

*Grupi "Liridona" që performoj natën e parë të Festivalit. Shumë emocione bashkë! Bukuri e pa shoqe, Bukuri Shqiptare, Bukuri Malësore!

Mark Paparisto dhe Anxhela Corri, përfaqësues të denjë të brezit të rinisë shqiptare, lindur e rritur në Amerikë, prezantuan Festivalin në gjuhën e nënës! Sa e zbukuruan Festivalin!?

Dhe kështu, me krenari shqiptare filloi Parada e këtij festivali, që do të zgjaste katër netë. Këta jemi ne, kjo është Diaspora Shqiptare, ky është Kombi ynë vital, sepse të tillë e mbajnë brezat që trashëgojnë historinë dhe traditën shqiptare.

Nga RAMAZAN ÇEKA,
Miçigan, korrik 2024



IDEJA KUSHTRIMTARE KOMBËTARE NË POETIKËN E ZEARBËRORIT DIBRAN DEMAKU

*Pjesë nga dorëshkrimi im
“Përsiatje letrare”*

Marrë në tërësi, përmbledhtazi, veprat poetike të tregimtarit, eseistit e novelistit të spikatur Dibran Demaku janë artikulum përmes figuracionit, ideve dhe anës formale, i vetëdijes poetike të një shkrimtari që tashmë e ka krijuar të qëndrueshëm stilin e tij, shprehjen e tij dhe botën e tij artistike. Duke kapërcyer nëpër aktin sistemor të krijimit, poezitë e këtyre veprave dalin si perla të përpunuara të metaforave fine.

POEZIA, si arti më i bukur letrar, është gjini e letërsisë, ku bota e brendshme, ndjenjat më sublime dhe frymëzimi hyjnor i poetit shprehen përmes shkronjave, të cilat krijojnë vargje. Vargjet, pastaj, shpalosin mendime, mendimet krijojnë energji, energjia ndez dritat e dijes, rrezet e arta të së cilës i japin ngrohtësi zemrës, mendjes dhe shpirtit, e me këtë, edhe kuptim dhuratës më të shtrenjtë, vetë jetës. Madje-madje, ato shpërfaqin edhe dashurinë më ideale ndaj kombit, atdheut dhe vlerave të tyre substanciale. Që nga Lekë Matrënga e Pjetër Budi, në periudhën e pararilindjes dhe, veçantë, gjatë Rilindjes sonë Kombëtare, e deri në ditët e sotme, kjo energji e prushtë eruptive nuk u ndalë asnjëherë së hedhuri farën e dijes, duke e kultivuar atë me dashurinë më të çiltër në shpirtin e pastër e fisnik të popullit shqiptar. Duke i mposhtur të gjitha sfidat e kohës, kjo frymë e shpirtit të popullit, xixat e saja të arta, si pishtarë të shpresës, u bartën gojë më gojë, mendje më mendje, zemër më zemër, brez pas brezi, nga kokat më të ndritura të kombit si: Naimi, Çajupi, Mjeda, Asdreni, Shiroka - për të vijuar tek Fishta, Konica, Noli, Migjeni, Lasgushi e të tjere, e deri në kohën tonë, duke u kthyer këta pishtarë e korifinj të letërsisë në flakadan të përhershëm që tashmë nuk ka forcë në botë që mund ta shuaj fuqinë e zjarrit të tij... Disa nga poetët më të njohur të kohës sonë, gjithashtu udhëhiqen nga ky flakadan në krijimet e tyre poetike, të cilët po e përplotësojnë dhe pasurojnë ca më thellë mozaikun e mrekullueshëm të letërsisë shqiptare.

Në këtë plejadë pishtarësh e krijuesish bën pjesë edhe tregimtari, eseisti, novelisti e poeti zëmëmëdhetar Dibran Demaku. Përveç lirikave të mrekulleshme plot zjarr dashurie ideale midis çifteve, në poetikën e tij kryefjalë është edhe brenga dhe dashuria e madhe ndaj vlerave thelbësore të kombit e atdheut.

Venerohet qartë që në poezitë e Dibranit riciklohen e tensionohen shkallë-shkallë fenomenet dhe situatat ekzistenciale të kombit. Të pranishme dendur janë sintagmat “gangrena anti-kombëtare” dhe “murtaja kancerogjene në organizmin e Arbërisë”. Kjo panoramë shqetësuese rishfaqet në shumë tekste poetike të këtij autori. Ato lënë të kuptohet se në hapësirën tonë, në arealin tonë kombëtar, po ndodhë, ose, thënë më saktë, veçmë ka ndodhur një tragjedi. Ato krijime lexohen edhe

si metaforë e kohëve mortore, ku janë katandisur keqas ca shqipfolës, që me këmbë rrojnë në Iliricum, por, mjerisht, me ëndrra fiktive e me meditime rrojnë diku në trojet lindore aziatike.

Poeti Dibrani na e tërheq vërejtjen përmes vargut të poezia “Gjeografi e atdheut”:

“Armiqtë të brejtën / pak nga pak / si minj të uritur vrimave / E ti në log betejash/ u këndoje këngë trimave / Shekujt iknin dalë nga dale / e ti bëje jetë kaçakqe në mal / Duke shitur dushk për gogël/ e tkurreshe e bëheshe i vogël, i vogël / Kur dielli të ndriqoi rrugën, jetën / nise të gërryesh vetëvetë”

Ndaj dhe Dibrani është në dilemë të thellë kundruall kategorive “patriot e tradhtar”, teksa vargëzon:

“Nuk po dihet / humbur na janë rrugët në oborr / nuk dimë nga po na vijnë plumbat qorr / nuk po dihet më kush është patriot a tradhëtar / dikush farë të keqe na ka mbjellur në arë...”

Mandej pason rënkimi, gjëma, pezma dhe protesta e tij të poezia “Miniatūra”:

“Të rrosh a të vdesësh / të vdesësh apo të rrosh / biletën të presësh / rezultati bosh! ...

Të marrësja të keqen Fan Nol / dhe ty Hasan Prishtinë / dikush na bëri gol / dhe na ndryshoi historinë!

Dikush thumbit dikush patkoit / si kofini pas të vjeli / merre briskun i prejme thonjtë / se asgjë tjetër nuk ngeli!

Iku festa, euphoria / u kthye jeta jonë reale / çfarë do shënojë historia / për mendjet tona fatale?!..”

Këtë galimatias, këtë shkërmogje e përdhosje të vlerave fundamentale kombëtare e ka nuhatur mirë Dibrani dhe ato i ka shpërfaqur me një gjuhë të qartë në poezitë e tij, si: “Ç’po ndodhë Kosovë me ty”, “Kur na erdhe liri, u koritëm”, “Fluturo Shqiponjë”, “Pop Pera”, “Si dje, si sot”, “Atdheut”, “Gjeografi e atdheut”, “Nuk po dihet”, “Nuk duam t’i shohim as rrezet e diellit”, “Në fund”, “Prishtinë”, Rrofsh Gjakovë” dhe “Qëndro”.

Veçanërisht ajo me titull “Ç’po ndodhë Kosovë me ty” - një poezi kjo e vargëzuar me rimë e figuracion, me mesazh të thellësisht kombëtar, që vë në thumb të kritikës në mënyrë sarkastike përdhosjen e vlerave substanciale të kombit nga maskarenj pseudo-fetarë. Poezi kjo, do shtoja, e qëndisur për mrekulli artistikisht në shkallë Himni kombëtar. Le ta lexojmë me vëmendje:

Çfarë po ndodhë Kosovë me ty

“Çfarë po ndodhë Kosovë me ty / po vë vetulla e po nxjerr sy / për ca dëngla ca fetare / po e rrënon historinë kombëtare / ca debilë ca klerikë të sotit / ta rrënojnë imazhin mot pas motit / si në kohët më të zeza / ty të shahet Nënë Tereza / si s’ të shembet nën këmbë dheu / kur të shahet Skënderbeu / si qëndron e ftohtë si guri / kur të përdhoset keq flamuri / ca klerikë me mendje tra-



Zekirija Idrizi Shkup dhe Dibran Demeku

pi / e bën vendin lesh arapi / po vë vetulla turko arabe / po nxjerr sy bilbili e shkabe / nëpër vite e nëpër shekuj / rrite trima e ngrite tempuj / tash ke mbyllur sy e vesh / ëndrrave tua u bie ndesh / populli i urtë populli i mire / rri anash e bënë sehir / i pëcet zemra tek kraharori / kur namaz bën profesori / e vogëlushja pesëvjeqare / mëson kuran jo abetare / çfarë po ndodhë Kosovë me ty / po vë vetulla e po nxjerr sy...”

Lëvizja radikale fundamentaliste e shqipfolësve me mentalitet beduinesk ka shkërmogur e përdhosur si mos më keq gjithandej trojeve tona vlerat më themelore të substancës sonë kombëtare. Këtë pështirosje e katrahurë vlerash Dibrani e ka shpërfaqur zëshëm edhe te poezia me titull “Kur na erdh liria u koritëm”. Ta lexojmë:

Kur na erdhe u koritëm

“Eh liri sa shumë të pritëm / kur na erdhe u koritëm / u koritëm me macë e kucë / e lam dritën sharruam në llucë / u koritëm me shkrim e fjalë / u koritëm në fushë e mal / nuk ta ditëm liri rendin / me godina kulti mbushëm vendin / që ta shtojmë më shumë korinë / vendit ia ndërruam gjeografinë / në mes të evropës në liri / e shndërruam vendin në arabi / tash minaretë që shpojnë qiellin / në gjuhë arabe e trishtojnë diellin / e trishtojnë diellin e trishtojnë hënë / për fe të huaj shajmë babanë e nënën / që marrëzia të jetë e plotë / gjuhën e nënës e bëmë skllotë / jo veç gjuhën por dhe faqen / në gjuhë të huaja e gjejmë paqen / nëpër shtëpi nëpër trotuare / nuk të zë syri asgjë kombëtare / herë jeta qanë herë jeta qesh / ardhmërinë e bëm për lesh / në mëngjes herët në mbrëmje vonë / nuk e njeh geni të zone / nëpër shekuj qëndruam shqiptarë / në liri u bëmë trutharë / së duam tjetrin së duam vetën / në ferr të zi e shndërruam jetën / eh liri sa shumë të pritëm / kur na erdhe u koritëm...”

Në këtë shpërftyrim vlerash me të dre-

jtë Dibrani ua zë fajin më së shumti predikuesve demagogë, hoxhallarëve që i thërrasin njerëzit, grixhat e tyre, nëpër ndeja, oda e xhami për të menduar e punuar për parajsën e asobotshme, ndërkohë që vetë ata pasurohen në kurriz të tyre. Të tillët janë djaj të veshur me petka engjëjsh, - thotë Dibrani. Demagogjinë dhe matrapazllëkun e tyre ai e demaskon pakompromis te poezia “Në fund”:

“në fund të gjithë do jemi ushqim për krimba / dhe nuk do vemi në parajsë as ferr/ mos i dëgjoni klerikët që në ujë bëjnë vrima / të ju mbajnë nën frikë dhe në terr / për veten parajsën e kanë në këtë botë / nga unë nga ti nga ai dhe të tjerë / tek helmin e / mashtrimet e pjmë në gotë / dhe ëndërrojmë në botën tjetër të kemi vlerë / ...në injorancën tonë mësuar e kanë notin / notojnë në ujëra të ëmbla që nga kohë e vjetër / në fund të gjithë do të jemi ushqim për krimba / dhe nuk do të vemi në parajsë as ferr...”

Por, Dibran Demaku në shkrimet e tij flet me një konsideratë të veçantë edhe për hoxhallarët patriotë e pishtarë të shkollimit. Ai rrëfen për dy hoxhallarët e fshatit të tij, Abrisë, Mursel e Hajriz Demaku, të cilët u bënë pishtarë të shkollimit të vajzave të fshatit, duke kontribuar shumë për çështjen kombëtare, duke ngritur vetëdijen dhe ndërgjegjen kombëtare te popullata, veçanërisht te fëmijët femra për emancipimin dhe shollimin e tyre.

Po me gjuhë sarkastike Dibrani i vë në thumb të kritikës edhe telallxhinjtë përtejkarpatianë serbo-sllavë, të cilin kishin ardhur në trojet tona me misionin e tyre djallëzor ultrafundamentalist për të shkombëtarizuar etnikisht, kulturalisht dhe fetarisht shqiptarët, duke trumbetuar atë tezën e tyre fantazmagorike shoveniste se gjoja Kosova është “Tokë e shenjtë serbe”, “Jerusalem serb”, “Djep i serbizmit” e të tjera. Në veçanti ai i sulmon ashpër “popat” serbë, të cilët, bashk me Kishën Ortodokse Serbe dhe Akademinë e Shkencave të saj, ishin farkëtuesit kryesorë të mega-projekteve të tyre fashistoide e gjenocidiste në kurriz të neve shqiptarëve. Le ta lexojmë poezinë e tij me titull “Pop Pera”:

Pop Pera

“Në katundin tim ishte një kishë / në të shërbente njëfarë pop pera / ne ishim çoban delesh e dhishë / kalonim rreth saj kur çilte pranvera

pop pera na shihte disi si me idhnim / në fytyrën e mërrolur i xixëllinin sytë / i tillë ishte në mbrëmje dhe agim / i rreptë si ai nuk gjeje një të dytë

nga kishte ardhur ne nuk e denim / thuhej se e kishin sjellur nga larg / sa herë e shihnim si të ngrirë rrinim / dhe ai qëndronte si statujë në prag

të rriturit thonin se kishte ardhë me detyrë / të na merrte tokat të na ndërronte emër / askush kurrë si pa buzëqeshje në fytyrë / veçse ne

Datëlindja e shoqërisë “Besa SHOSH”

Gjithkush kujton dhe feston datëlindjen e vet!

Ne, shoqëria “Besa Shosh” kujton datën e themelimit të shoqërisë kulturore “Besa-Shosh”!

Ishte data 8 korrik 2018, kur një grup nismëtarësh të lindur, rritur dhe formuar në lindjen e folklorit nder tërveza, dasma, gëzime dhe veprimtari artistike në Shosh, që ideuam dhe menduam të formonim një shoqëri kulturore me emrin ‘BESA – SHOSH’, në shenjë mirënjohje për virtytin më të lart njerëzore të manifestuar në nivelin më të lart në vendlindjen tone, Shosh, në të cilën disa herë burra të nderuar dhe të pavdekshëm dhanë jetën për këtë fjalë ëmën madhe dhe domethënëse.

E ku ma mirë mund ta ligjëronim se në vendlindje, me rastin e një manifestimi kulturor të zhvilluar nga Bashkia Shkodër në Shosh.

Ndaj, ne shfrytëzuam këtë veprimtari kulturor për të shpallur formimin e grupit tone, Shoqëri kulturore e pagëzuar me emrin “Besa Shosh”.

Prej asaj dite shoqëria jonë ka pas veç arritje dhe suksese.

Paraqitjet tona kane kenë shumë të niveli të larte si brenda dhe jashtë vendit, duke u vlerësuar me çmime dhe medalje të ndryshme herë mbas here, por sot nuk do zgjatemi pasi historiku i shoqërisë sonë është mirëshkruar.

Së pari, në këtë datë dua ti falënderoj të gjithë ideatorët dhe nismëtarët e kësaj shoqërie, duke filluar nga administratori i komunës Shosh, z. Ndoc Ashta; z. Prel Milani - shkrimtar, poet, historian e publicist, që ishte shumë aktiv, që edhe sot është sekretar i shoqërisë; z. Lazer Kodra,

shkrimtar, poet e publicist.

Së dyti, dua të përsënderes të gjithë shokët e shoqërisë, që ishin shumë të disponoheshim për gjithçka pa kursyer asgjë, në shërbim të grupit, duke kontribuar edhe materialisht çdo here, për mbarrëvajtjen në realizimin e misionit të shoqërisë.

Por në veçanti një falënderim të veçantë sot e kam për kryetarin e kësaj shoqërie, z. Ndoc Fusha pa të cilin ne nuk do ishim sot në këto nivele. E them këtë, sepse në saj të kontributit të tij, ne sot kemi studio tonë audio dhe studio video nder macilësoret në Shqipëri, që ju, që e keni pare nga afër nuk keni pas asnjë sugjerim, por për ju që nuk e keni pare nga afër, ju ftoj ta vizitoni dhe pastaj flasim.

Me këtë rast dua të falënderoj shoqatat si motra brenda dhe jashtë vendit, për mbështetjen që na kanë dhanë në këto vite:

Së pari, Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, grupin “Treva”, unionin mbarëkombëtar “Sofra Dardane”, shoqata “Malësia”, shoqatën “Plisbardhet” e të tjerë e të tjerë!

Kjo është një vlerë e çmuar për ne!

Por, në këtë datë dua të falënderoj pa mase të gjithë miqtë tonë kudo që janë, për mbështetjen e tyre të vijueshme me fjalë, me sjellje e me kontribute që na kanë dhanë. Faleminderit shumë, respekti dhe mirënjohje pa kufi për ju miq!

Në fund dua të uroj gjithë nataret e shoqërisë sonë!

Gëzuar 6 vjetorin dhe festën e lindjes të shoqërisë!

Shoqëroja jonë festoftë qindra vjet!

Rapsodi GJON KOSTERI



◀ fëmijët e urrenim me zemër...
... dikur fryu një erë, një erë e lehtë / pop pera iku nga sytë këmbët / veçse emri i tij gjithkund ka mbetë
në ara e livadhe dhe...në oborr tek lëmët...”

Mesazhi përfundimtar, si porosi e fuqishme kombëtare, i Dibranit shpërfaqet te poezia “Qëndro”, ku kërkon të ruhen e mbrohen me fanatizëm vlerat fundamentale të identitetit dhe kulturës sonë kombëtare:

Qëndro

“Për fis e për fare / për gurë e për arë / qëndro-shqiptar
për prag e për voter / për vëlla e për motër / del flijohu në kodër

për lis e për fis / si një qiparis / jeto ose vdis...”

Këtë mesazh ai e vargëzon po kaq fuqishëm edhe te poezitë “Prishtinë” dhe “Rrofsh Gjakovë”, ku ndër të tjerash vargëzon:

Prishtinë

“Feniks i djegur dhe i rilindur ne flake / dëshirë dhe ëndërr e vizatuar në shuplakë / ti pika o(zero) e Kosoves mëmë / lot i derdhur dhe i shuar ne syrin tend / të dua për rënië dhe ngritjet e tua / flakë dashurie gjithmonë e ndezur në mua”

Prishtinë

“Sa herë vijmë dallendyshet në fillim vere / ti i pret tek porta dhe u hap derën / së bashku me dallëndyshet vijmë edhe shqipet

/ kush me lot të ëmbël kush me lot të kripët”
Prishtinë

“Ngritur je mbi gjakun dhe eshtrat e të rënëve për liri / sepse ti je Kosovë ...sepse ti je Shqipëri”

Rrofsh Gjakovë

“Rrofsh Gjakovë bijë e atdheut / kurrë Çabratit s’të mbuloi hija / me shtatoren e Skënderbeut / po ringjallet shqiptaria
Gëzon fusha gëzon mali / këtu nuk ka vend trinia / qupë pas qupe e djallë pas djali / këtu do rritet shqiptaria...”

Dorën në zemër, këto poezi i bëjnë një nder të veçantë kauzës sonë kombëtare nga gjitha pikëvështrimet. Ato, neve si krijues, na sugjerojnë që në krijimet tona

të ngremë zërin lart kundrejt gjitha përdhosjeve dhe përbaltjeve që ia bëjnë kauzës sonë kombëtare anti-shqiptarët miopë fundamentalistë.

Uroj që Dibrani edhe më tej të na befasojë me perla e margaritarë të tjerë të çmuar letrarë!

Me respekt dhe konsideratë të lartë atdhetare për këtë poet zëarbëror!

Zekirija Idrizi Shkup

POEZIA KA FUQINË E LIRISË

**Parathënie e vëllimit antologjik
“VARGNIM GJAKOVE”**

Teksa libri me poetët e Gjakovës bëhet gati të shkojë drejt shtypit, me përvetësimin më të madhe dhe me një ndjenjë të pakufishme respekti, ulem të shkruaj këtë parathënie. Vetë emri “Gjakovë është metaforë”, është simbol i një sërë ndjesish të krijuara nga procese e ngjarje të ndodhura e të përjetuara nga njerëzit e Gjakovës në shekuj e dekada, ndjesi të cilat tashmë i rrinë këtij emri si një aureolë. Përgjithësisht, historia e çmon këtë vend me një konsideratë fisnikëruese, që në fakt është një marrëdhënie mes gjithçkaje të ndodhur këtu në kohëra vëlimesh e kthesash për popullin shqiptar. E sigurisht, një rol të pamat kanë luajtur edhe njerëzit e pendës, të shkollimit e të artit. Ata, si bashkëpërjetues të të gjitha dhimbjeve e lavdive në të panumërtat krajata, u bënë zëdhënës shpirtëror të lotit të lindjes a të vdekjes, të fitores a të humbjes, të tragjedisë a të ngadhënjimit mbi të. Duke sublimuar deri në caqet më të larta njësores emocionalitetin e popullit nga vinin e duke qenë në themel të komunikimit sa artistik po aq edhe human, artistët u bënë gjenerues të asaj energjie që përçon larg; larg në kohë e në hapësirë, për të bashkëndjerë e për të bashkëndarë si bashkëvendas pulsën shpirtëror në sfidimet e shumëfishta në përballje me okupuesit, në mbrojtjen e interesave kombëtare, në rropatjet ndaj ekzistencës, në frustrime kulturash e erërash epokale, të cilat janë përplasur në trojet tona si dallgë të pamëshirshme.

Në këtë vëllim, janë veçuar qëllimshëm nga unë, letrarët, konkretisht poetët, që me vargjet e tyre i ngritën pedestal nociove të larta nacionale e humane. Me burimet e pashtershme të përjetimit dhe të fjalës, ata sollën përgjithësisht një krijimtari të dedikuar dhe të vetëkushtëzuar nga tematika kundërvënës ndaj robërisë, tematika e mbrojtjes së dinjitetit dhe lirisë, e mbrojtjes së simboleve kombëtare, e fjalës së lirë të munguar e të tjera. Prandaj poezia e tyre ka fuqinë e lirisë!


Zeja e poetit nuk është aq e lehtë sa duket, sidomos në periudhën e paraçlirimit të Kosovës, para se të ngjyhej në bojë, pena duhej ngulur në mish; para se fjala të dilte, duhej guxuar e rrezikuar pasi fjala, vargu, arti ishin kthyer në armë. Poetët kishin vetëm një armë në këtë luftë të ashpër dhe në këtë ndeshje titane: vargun. E përveç gjithë të ligave të tjera, ata hapëronin me rrezikun se mund të anatemohej, të paragjykohej, të përrallej e të denigrohej, pasi makinacionet e shumëfishta nuk bënin gjumë as natë, as ditë.

Në rrugën e të bërit art, të afirmuarit është një proces i ngadalshëm e i përkallshëm në të cilën krijuesi reflekton qartë dhe ndikon spontanisht. Ai i përcjell nën lëkurë ndryshimet në shoqëri. Adhurimi për autorë si: A. Çeta, E. Gjerqeku, D. Mehmeti, R. Hoxha, B. Bokshi, A. Musaj, S. Lokaj, M. Nura, A. Gjakova, A. Podrimja, T. Dërvishi, M. Kupa, M. Bobi, M. Saneja, S. Rexhepi, H. Haxhosaj,

A. Byci, A. Deva, F. Brovina, A. Mala, F. Ymeri, F. Rexha e të tjerë, e të tjerë, vjen pas madhështisë që ata ndërtuan me krijimtarinë dhe ndikimin e madh të saj. Me shumë të drejtë quhen poetët e plejadës. Gjendja artistike që ata sollën ishte



dëshirë për të frymuar lirshëm, nevojë për kacafytje me të pamundurën, këlthitje për çprangosje, dëshmim për të drejtat e mohuara, akuzë për krime të qëllimshme. Këta, e jo vetëm këta tema, u kthyen në një traditëshmëri për kohëshmëri të gjatë dekadash. Është e qartë se pjesa më e madhe e të pranishmëve në dy gjeneratat e para nuk janë thjesht krijues por personalitete të mirëfilltë të artit dhe mendimit shqip. Ata nuk ishin vetëm krijues por edhe veprimtarë të çështjes shqiptare, promovues dhe mbrojtës të hapur të të drejtave të popullit të tyre, gjë të cilën e bënin hapur jo vetëm në art.



Historia e re e Kosovës flet zëshëm për veprimtarinë e tyre, ndërsa poezia mbetet vetëm një pjesë fragmentare e kësaj veprimtarie. Sigurisht se trajtimi i mëtejshëm i krijimtarisë, gjuhës dhe stilit të përdorur kërkon një observim të thellë dhe përmbytësor dhe secili nga ta është unik, me përparësitë dhe me kufizimet e veta. Ndaj, edhe poezitë e përfshira në “Vargnim Gjakove” janë një reflektim i sinqertë për të kaluarën, një prani paqeje e dashurie në të tashmen dhe një shqetësim human mbi të ardhmen. Të gjitha këto të shtjelluara me një thellësi mendimi dhe lehtësi rrëfimi që rrallë haset. Ato jo vetëm që na ofrojnë kënaqësinë e leximit, por edhe na bëjnë të reflektojmë dhe të besojmë thellë për ideale të fuqishme.

Sot, autorët e lartpërmendur, rreshtohen në panteonin e poezisë shqipe, pasi koha nuk i ledhatoi e as fati nuk i kurseu. Mbeten të adhuruar për atë që sollën në poezi dhe jo vetëm në poezi.

Në vigjilje të përvjetorit të 60-të të Mitingut të Poezisë dhe në nderim të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës, me një entuziazëm të pasiq, nisa të ideoj një përmbledhje me poezi nga poetët e Gjakovës. Mendimet që dalin nga zemra peshojnë e kanë shumë vlerë ndaj unë i dhashë jetë mendimeve të mia dhe i ktheva në një realitet. “Vargnim Gjakove” e quajta, me dëshirën më të mirë që secili prej poetëve të ketë vendin e tij në këtë radhë poetizues, e cila më ngjan me një varg rruazash apo perlash ku secila prej tyre ka ndriçimin dhe bukurinë e saj.

Do ta quaja një vëllim festiv, dhuratë imja në përmbylljen e dekadës së gjashtë të Mitingut. Mitingu ishte mbajtur për herë të parë në vitin 1964, sipas idesë së

Din Mehmetit dhe Enver Gjerqekut, me bashkëaktivizimin e miqve të tjerë poetë, për t’u institucionalizuar pak kohë më vonë me formimin e Klubit letrar “Gjon Nikollë Kazazi” (1967). Në vite e dekada, në të kanë marrë pjesë me qindra poetë nga e gjithë Kosova, me dhjetëra e dhjetëra nga Shqipëria e viset e tjera shqiptare, e po ashtu, me dhjetëra poetë të huaj pasi veprimtaria ishte e rangut ndërkombëtar.

Poetëve në vëllimin “Vargnim Gjakove” i paraprijnë pesë poezi nga personalitete përgjithësisht klerikë fetarë, poezitë e të cilëve datojnë nga shek. XVII e këndej: Y. Efendija (shek. XVII), Gj. N. Kazazi (shek. XVIII), T. ef. Gjakova (shek. XVIII), T. Zajmi (shek. XIX) dhe A. G. Bojaxhiu (shek. XX). Krijimet e paraqitura nga ata janë një pasuri e rrallë jo veç për vlerat artistike sa për humanitetin dhe origjinalitetin, që na vjen i reflektuar aq bukur nga kohësi të largëta. Nuk ka asnjë mëdyshje që edhe këto figura i përkasin arealit të Gjakovës, madje edhe Nënë Tereza - mbesë Gjakove, e bija e Dranes së lindur në Novosellë.

Më tej, në libër renditen katër gjenerata poetësh: I (1920 – 1940), II (1941 – 1960), III (1961 – 1980), IV (1981 – 2010), që secili poet përfaqësohet me dy krijime (dy gjeneratat e para) dhe me një krijim (dy gjeneratat e dyta). Renditja është bërë kronologjikisht sipas vitit të lindjes. Fillohet me vargjet e Anton Çetës, pajtimtarit dhe veprimtarit të madh të besës e të fjalës dhe përfundohet me poeten e re 19 vjeçare, Olsa Domi, autore e dy vëllimeve. Përfshirja e poetëve i ka tejkaluar të gjitha paragjykimet personale e tejpersonele që te dikush mund të shfaqen qëllimshëm apo shkarazi, sepse në art nuk ka vend për lakmi e për zemërligësi. Për secilin krijues flet vetë arti dhe krijimtaria që ka sjellë në vite ndaj të gjitha diskutimet me sens inatçor dhe dashakeqës bien poshtë.

Ky vëllim i lë vend vetëm poezive, pasuruar dhe dizajnuar me foto, pasuar nga disa fjalë në sensin biografik për secilin autor. Ndërsa vëllimi i radhës, që kam në përgatitje e sipër është një studim letrar, për këto individualitete krijuese.

E tani që “Vargnim Gjakove” me poetët e Gjakovës është i gatshëm, nuk është koha për të marrë lavde, por është momenti i duhur për të dhënë nderime. Nderime për të gjithë ata që shpirtin e tyre e kthyen në varg e vargun në përkushtim shpirtëror për një pjesë aq të rëndësishme të qenies së njeriut, sikurse është vendlindja, fëmijëria, shtëpia e prindërve a trualli, të cilit i përkasin, pasi njeriu pa këto do të ishte njeri pa atdhe. E një njeri pa atdhe, është një njeri i mbetur pa asgjë.

Në fund, dua ta mbyll me ndjesinë e një njeriu që ka bërë punën dhe tashmë nuk i kanë mbetur më fjalë, duke i mbyllur sytë dhe duke parë me dritën e shpirtit, diçka më pëshpërit: Aty ku ka poezi ka emocion, dhe aty ku ka nderim për poezinë ka fisnikëri!

**Dr. Migena ARLLATI,
Gjakovë, 24 prill 2024**

Shkrimtari Voc Dedë Mjetaj, nuk do të vijoje më në punën e tij hulumtuese e krijuese?!

Shkrimtari Voc Dedë Mjetaj, me datën 12 Gusht 2024 u nda nga jeta, duke lënë në pikëllim të thelle bashkëshorten Terezina Mjetaj, djemtë Ervisin, Oltonin dhe vajzën Manjolen, vëllain Sokolin, nipa e mbesa, të afërmit, miq e shoqe, prej të cilëve u përcoll për në banesën e fundit.

KUSH ISHTE VOC DEDË MJETAJ?

Voc Dedë Mjetaj ka lind më 21 Korrik 1941, në fshatin Xhan të krahinës së Pultit, në një familje me tradita patriotike atdhetare, i biri i Dedë Vuksanit dhe i Luke Gjones.

Voci, ka mbaruar shkollën shtate - vjeçare në fshatin Xhan, shkollën e mesme të kuadrave e ka kryer në Tiranë, në vitin 1970, ka mbaruar shkollën e larte në Tiranë për Histori, Filozofi dhe Ekonomi politike në vitin 1976.

Voci ka punuar rreth 40 vite në detyra e funksione të ndryshme, në pushtet, në ekonomi dhe në ushtri, në zonën e Dukagjinit, të Malësisë së Madhe dhe në qytetin e Shkodrës.

Në vitin 1964-1968 ka punuar në detyrën e Kryetarit të Këshillit Popullor të fshatit Xhan. Në të njëjtën kohë, ka punuar edhe në detyrën e anëtarit të Këshillit Popullor dhe Anëtar i Komitetit Ekzekutiv në zonën e Dukagjinit.

Në vitin 1966-1968 ka punuar në detyrën e Kryetarit të kooperativës bujqësore të fshatit Xhan.

Në vitin 1970-1972 ka punuar në detyrën e Kryetarit të kooperativës bujqësore në fshatin e Thethit.

Në vitin 1972-1974 ka punuar në detyrën e Z/Kryetarit të pare, në kooperativën bujqësore të bashkuar të Pultit.

Në vitin 1976-1979 ka punuar në detyrën e Z/Kryetarit të parë të kooperativës bujqësore të bashkuar Shalë.

Në vitin 1976-1979 ka kryer edhe

detyrën e Z/Kryetar i Këshillit të Bashkuar dhe Z/sekretar i Byrosë Partisë për krahinën e Shalës.

Në vitin 1977-1979 ka kryer detyrën e oficerit rezervist, Komisar i Grupit të For-



cave Vullnetare për zonën e Dukagjinit (Shalë, Shosh e Pult).

Në vitin 1979-1988 ka punuar oficer aktiv, në detyrën e Komisarit të shkollës së Lirë Ushtarake, në Grizhë, në Malësi të Madhe. Në të njëjtën kohë ka kryer edhe detyrën Z/sekretar i Byrosë Partisë për kooperativën bujqësore Grizhë dhe Z/sekretar i Byrosë Partisë në Brigadën e Këmbësorisë në Shkodër. Në vitin 1988-2002 ka punuar në detyrën e shefit të kuadrit dhe i organizimit në Regjimentin Kundërror, me qendër në Tepe, për qytetin dhe rrethinat e Shkodrës.

Voci për punën e mirë të kryer, është dekoruar 5 (pesë) herë nga Kuvendi Popullor:

Në vitin 1962 është dekoruar me medalje "Për Trimëri e Vigjilencë në ruajtjen e kufirit R. P. S. Sh";

Në vitin 1968 është dekoruar me medaljen "Për punë të shquar në ekonominë bujqësore", për organizimin, drejtim të mirë të punës, për rezultatet e arritura dhe plotësimin e tejkalimin e detyrave të planit prodhimit";

Në vitin 1980 është dekoruar me medaljen "Ylli kuq" për punë të shquar dhe rezultate të larta;

Në vitin 1988 është dekoruar me "Urdhërin e Shërbimit Ushtarak" të klasit III;

Në vitin 1991 është dekoruar me "Urdhërin e Shërbimit Ushtarak" të klasit II;

Gjatë karrierës është nderuar me tituj nderi:

Në vitin 1962 është nderuar me Fletë-Nderi nga K.O.B.R.P.SH "Për trimëri e vigjilencë në ruajtjen e kufirit R.P.S.SH";

Në vitin 1962 është nderuar me "Fletë-Nderi për kryerjen e detyrës në mënyrë shembullore. "Për trimëri e vigjilencë në mbrojtjen e kufirit të shenjtë R.P.S.SH." nga Komiteti I Rinisë së rrethit Librazhdit. Në vitin 1977 është nderuar me "Fletë-Nderi, "për disiplinë dhe ndërgjegje të lartë në përvetësimin e kërkesave dhe zbatimin e detyrave të përgatitjes politiko-luftarake" nga Komanda e repartit 1505.

Në vitin 1965 është nderuar me Fletë-Nderi, nga komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit Shkodër si "Kuaër Shembullor për kryerjen e detyrave të pushtetit";

Në vitin 1965-1968, Komiteti Ekzekutiv dhe Komiteti i Partisë e kanë vendos fotografinë në këndin e emulacionit, në qendër të qytetit në Shkodër, me motivacion: "Kuaër shembullor për kryerjen e detyrave të pushtetit";

Voci, me 4 janar 1980 ka krijuar familjen me Terezina Mjetaj, nga fshati Lotaj e krahinës së Shalës dhe kanë tre fëmijë: Ervisin, Manjolen e Oltonin, të shkolluar dhe me familjet e tyre.

Në vitin 1980-1991, Komanda e Divizionit Shkodër i ka vendos fotografinë në këndin e emulacionit të Divizionit dhe në shtëpinë e Oficerëve, me motivacion: "Ushtarak shembullor";

Në vitin 1990 Ministria e Mbrojtjes Popullore e ka nderuar me Çertifikatën "Ushtarak Shembullor";

Në vitin 1990 komanda e Divizionit e ka nderuar me Flete - Nderi "Ushtarak shembullor në realizimin me sukses të detyrave të përgatitjes Politiko - Luftarake";

Në vitin 1990 komanda e Brigadës së Këmbësorisë me qendër në Tepe e ka nderuar me Flete -Nderi, me motivacion: "Ushtarak shembullor në realizimin me sukses të detyrave të përgatitjes Politiko - Luftarake";

Voci, nga Kryesia e Shoqatave Atdhetare "Dukagjini" është nderuar me titullin "Diplomë Nderi" për kontributin e tij si shkrimtar, me vendim nr. 9, me 20 dhjetor 2005; Gjithashtu, me vendim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", nr. 235, date 7 shtator 2017, me titullin "100 vite arsim e kulturë në Dukagjini".

Voci është anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"; anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të rrethit e të Qarkut Shkodër.

Ka shkruar dhe botuar:

1. Thesare Dukagjinase" në 7 volume:

*Thesare Dukagjinase - 1 - 2002

*Thesare Dukagjinase - 2 - 2004

* Thesare Dukagjinase - 3 - 2004

* Thesare Dukagjinase - 4 - 2006

* Thesare Dukagjinase - 5 - 2006

* Thesare Dukagjinase -6 - 2011

* Thesare Dukagjinase - 7 - 2018

8. Bisedë me rininë - 2005

9. Dokumente, data dhe shënime historike- 2007

10. Kuriozitete - 2007

11. Historiku i fshatit Xhan -2007

12. Historiku i familjes Mjetaj -2007

13. Historiku i Vllaznisë Dedajve -2012

14. Ftesë për dituri - 2014

15. Dy Epoka homerike -2015

16. Fol Shqip - 2017

17. Sekretet e ushtrisë Shqiptare - 2019

18. Historiku i zonës së Pultit - 2020

19. Mitologjia në trevën e Dukagjinit - 2021

20. "Urtësi Dukagjinase", me 5000 fjalë të urta, 546 frazeologji dhe 300 nocione Filozofike.

Kjo është jeta dhe një dite do të ndahemi prej saj, megjithëse Vocin e donim përsëri në mesin tonë, për fjalën e urtë, për shoqërinë dhe humorin e holle të tij në çdo çast, ai do të mbetet i paharruar nga bashkëshortja dhe fëmijet, vëllai Sokoli, të afërmit e tjerë, ne miqtë dhe shokët e tij.

I përjetshëm qoftë kujtimi i shkrimtarit Voc Dedë Mjetaj!

Lamtumire Voc Dedë Mjeta!

NDUE SANAJ, AGRON HASANAJ,
ROZA PJETRI, LEZE BUNGAJA,
KOLË ÇARDAKU, PRELE MILANI
E PRELE SHYTANI



PARAMETRAT E DIMENZIONEVE LETRARE



Brahim (Ibish) AVDYLI

Në vend të përmbylljes

Pa i përmendur dy vepra të Prend Ndue Buzhalës të ndalura në shqyrtim të mëvonshëm, “Një re pa atdhe / Tregime me pak fjalë”, SHB “Lena”, Prishtinë, 2023; romanin e fundit, “Në kapërcyell”, SHB “Lena”, Prishtinë, 2020, sikurse dy romanet e tjera për shqyrtim, “Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë”, 2003; “Njerëzit prej faqeve të dritës”, 2019; përmbledhja e tregimeve “Një buzëqeshje përtej varrit” (Tregime pleqërishte për një roman me frymë të shkurtër), SHB “Lena”, Prishtinë, 2023, apo ndonjë vepër tjetër e mëparshme, me poezi apo tregime, do të thotë se në të gjitha format e saj, na kompletohen të gjitha dimensionet e veta letrare.

Do të përpiqemi që të vëmë disa gjëra në spikamen tonë. Çka kemi thënë nëpër studime tonat, i kemi thënë e nuk po i përsëritim. Edhe këto të tjerat janë në një vijë të dimensioneve të tij letrare.

Në veprat e tij, “Në kapërcyell” dhe “Një re pa atdhe”, mund të themi se janë pasqyrë e thellë vrojtuese e një krijuesi pa atdhe të vërtetë dhe me një dyshim të thellë krijues, pasi ai nuk konsiderohet se është “në mesin e të gjallëve”, por jeton dhe ka dëshirë prap që të na thotë diçka. Njëherë, e thotë “të vërteten” e brezit të tij dhe të brezave paraardhës prej fillimit, për të gjitha gjeneracionet pas tij. Të themi se Prend Ndue Buzhala na ka mbetur pa atdheun shpirtëror të shqiptarëve, pra “të albanëve” (këtu po e themi se italianët “l”-në latine e kanë zëvendësuar me “r” e emrit tonë të parë, këtë po e them për herë të parë, që ta shihni edhe ju: arbanë-albanë!), i cili është shumë më i madh se të jesh “Kosovar”. Cassova (Kasova) është një emër i një kështjelle të Dardanisë dhe nuk është emër i popullatës ilire. Emri nuk e ndërron gjakun! Gjuha është prej tuli, e vërtitet andej e këndej, nëpër gojë. Ajo nuk na ndërron trajtën, edhe kur na fyejnë. Kështu mbetet një vizë e vogël e parametrave letrare, e nuk do mend se këto janë disa dimensione letrare. Vendlindja e tij ka mbetur një pjesë e vogël e “Atdheut”, e cila sot na thirret “Republika e Kosovës”. Ajo është pjesë e vogël e “Shqipërisë” së denjë...

Jo pse ne nuk kemi talent të shkruarjmë, jo pse nuk kemi aq shumë vepra të këtij shkrimtari të denjë, Prend Ndue Buzhala, të cilat na rrethojnë e shkojnë

përtej mendjes sonë, etj.; ne po e sjellim një thënie të vetme, të një profili të FB, që veten e quan “shqiptaro-madhi”, i cili na e sjell me dhembjen e tij të madhe, një thënie zhvlerësuese, që një gjerman ia përcjell atij, edhe pse ata aq sa janë pro nesh, janë me rusët e lidhur contra nesh:

“Trimat, ua ka vlarë armiku! Të menqurit, i keni vlarë vet! I ngjani shqiponjës. Si të hypni lart, shikoni si t’i hani këta poshtë!”

Për shembull: më i afërti është vëllai, që ta ka lindur një nënë dhe një babë; është i pari që të kthehet kundër. Ti e do shumë, por ai të shkatërron... Ju, shikojeni tregimin tim, “Vetvrasja kolektive”, apo këto shqyrtime, një nga një: “Heroi i rrugës”, SB “Lena”, Prishtinë, 2017; “Ani i ilirishtevë”, SHB “Lena”, Prishtinë, 2020; “Sizifi pa gurin e tij”, SHB “Lena”, Prishtinë, 2020; dhe “Këngëz me errësirë blu”, SHB “Lena”, Prishtinë, 2022, dhe do ta gjeni nga një pjesë të vërtetës së shkruar. Do t’i gjeni konkordancat.

E vërteta është spirale e asaj që njerëzit e kuptojnë si “të vërtetë”, apo nuk e kuptojnë kështu. Pjesërisht e shohin apo nuk e shohin si “të vërtetë”, e ata duan në radhë të parë t’a kudërshtojnë. Jo të gjithë se e shohin me sy dhe e masin me zemër, por duhet t’a pyesin mendjen. E mendja është e treta që të pyetet, çka mendon ajo për këtë gjë. Në fakt, shumica e shqiptarëve na e harrojnë zemrën e tyre, të cilën e kanë si masë të të gjitha të vërtetave. Kur vrapon mendja para se të nxirret zemra, si taban i njeriut, e pjesa dërmuese nuk e llogaritin ndërgjegjen që të përcjellë kudo dhe e vërteta na duket se është një gjë relative, në qoftë se do t’a kuptosh kështu këtë gjë. Në të vërtetë, zemra e ndjenë, sytë e shohin dhe mendja e di.

Ne, jemi vërtet një komb që nuk llogaritet se është një komb i vërtetë i shqiptarëve, por bij ilir, yllor, arban/arbër, që quhemi “bij të Shqiponjave”, e “shqiponjat” i vrasim të gjitha, kur të kemi mundësi më të praptë. Dheun tonë na ka lënë me trashëgimi Ati ynë, prej ATIT TË SHENJITË. Ne, vëllezërit tonë i denigrojmë tërësisht, kur nuk kemi mundësi që t’i zëmë me grusht të dorës, sepse janë të ndarë apo të shpërfillur në të tërë botën, ku kanë një vend të vogël për të bërë stofullën e tyre, të pa rënë në sy. Ikim prej vetvetes. Vendin tonë e kanë sulmuar armiqtë tanë nga të gjitha anët, e armiqtë më të rrezikshëm janë këta: “grekët” e dhunshëm, sepse historikisht nuk quhen ashtu, por graitë, numri shumë i grave tona, “serbët” gjakpirësa, pa asnjë fije të karakterit (serb=serpente, nga latinishtja!), një popullatë mikse nga gënjeshtarët më të tmerrshëm në botë, me disa “nobelistë” dhe më të zgjedhur nëpër Europë; pastaj vinë të tjerët rreth e rrotull nesh, me “rusët” e mëdhenj, që fenë ortodokse e kanë shndërruar në profil aktual të shtetit dhe përpiqen që ta zgjerojnë nëpër botë, së bashku edhe me të tjerët. “Bullgaromakedonët”, të cilët na quhen kështu, na e vjedhin emrin “makedonia” dhe Aleksandërin e Madh, që shqip ka folur, por shkolluar në gjuhën artificiale të “Graecias”, që nuk ka qenë “gjuhë shqipe”, por e

krijuar prej të huajve...



Së fundi, kemi mbetur nën katër “shtete” pa rrënjën tonë, që të tjerët na i kanë zapuar trojet tona dhe janë më përpara se ne të futur në Evropën e Bashkuar: Greqia, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, dhe Republika e Kosovës, jashtë Republikës së Shqipërisë, e cila e puthë “serbin” Vuçiq në gojë, e ne, që jemi shqiptarë, nuk na do! Në parahistori, kemi qenë i dyti komb në botë, pas indianëve të Indisë, me Azinë e Vogël, Egjiptin, pjesën dërmuese të tokave në Babiloni, Irakun e tokat e tjera deri në Republikën e Alergjisë apo Marokun, Europën si kontinent, së bashku ato me Britaninë e Madhe e deri në Amerikë. Sot, nuk mund të merret një gjë e tillë me mend!

Prej “shtetit të pabashkuar shqiptar”, me Republikën e Shqipërisë, që nuk është

shtetin e madh ilir, e në prapavijë të tyre u bëmë ne, si një shtet i kthyer në shtet të vogël e “multinacional”, me rrymat që ta pinë gjakun me gotë. Më tutje, nuk ka nevojë që të flitet! Ju, shpalojeni të vërtetën në këto shkrime, si është më së miri; e gjeni të vërtetën e pathënë apo të thënë simbolikisht!...

Kudo na flasin gjuhë të tjera, në vend të gjuhës shqipe. Edhe në Gjakovë na ka mbirë një “birë bushtre” nga Turqia, por është specializuar në Rumani (e Rumania është ortodokse!), pa e marrë parasysh se prej kujt na e marrin emrin “Serbistan”, është kurde, e jo iraniane!...

Të bien lotët në sy dhe të sillet e tërë bota për rreth! Ti, nuk je i pari, as i dyti, as i fundit, por fundi i fundrrinave të botës! Bota të bëhet spirale, e të sillet me akuza, me demonë, me kundërshtarë të Zotit



siç duhet të jetë, kemi mbetur në Kosovën Veri-Perëndimore, e do të duhej të ringjallej Mbretëria e Dardanisë dhe Çamërisë së pakrijuar, në Jug-Lindje, apo si të duoni që t’i llogaritni. Për shembull, duhet që të isha si “Kryetar”, i ringjalljes së Baba Fajës, i cili është zhdukur nga regjimi i ri Shqipërisë, me atë shtet të vogël, të “RPS e Shqipërisë”, me të cilët e ka krijuar atë shtet, pas “çlirimit”, me ruso-serbët e të tjerë, që duhej ta shkatërronin tërësisht

të Madh, me “jo”-të, në vend të “po”-së. Germa apo shenja e kthen drejtimin e çështjes...

Shikojeni njëherë këtë godinë të botës, me disa kate e kate, midis yjeve apo planeteve. Jemi energji, të gjithë jemi të bërë prej energjive tona, të energjive të mendimeve tona, deri në errësinën e plotë. Janë parametrat e dimensioneve tona. Parametri është tregues i njëres prej vetive të një krijimi, që përmban

DASMË TRADICIONALE E MODERNE

Muajt e verës janë muaj gëzimi për familjet shqiptarë, veçanërisht muaji gusht, i cili në fjalorin e zakonshëm quhet edhe muaji i dasmave.

Emigrantet kthehen në Shqipëri për pushime e pse jo për të bërë lidhje martesore. Djemtë e vajzat shqiptare jetën e tyre e lidhin edhe me partner nga vendet e Evropës e më gjerë. Duke ju larguar martesave vetëm me Shqiptar. E thënë troç integrim e civilizim me botën e përparuar, perëndimin na ka bere pak ndryshime në jete e gjendjes civile!

Një dasmë madhështore u organizua nga Gjak Vuksani nga fshati Lekaj, i krahinës së Shalës, i cili martoi fëmijën e tetë. Martoi Sebastian Vuksanin me Raluca Cornita nga Anglia, organizimi i kësaj ngjarjeje kaq të rëndësishme, është gëzim i madh për të gjithë familjen dhe veçanërisht për çiftin, që nga zemra i urojmë: Të trashëgohen e jetë të lumtur! Në këtë dasmë krahas të ftuarve me qindra e qindra nga Shqipëria, marrin pjesë me dhjetëra e dhjetëra të ftuar nga Evropa, por edhe pothuajse nga të gjitha kontinentet. Miqtë e ardhur nga Perëndimi ja rritën bukurinë kësaj nate të 10 gushtit 2024. Muzika vazhdonte dhe koktej ishte në

kulmin e tij, takoheshin e përqafoheshin mes tyre, duke ju përmbajtur traditës.

Dasmën e deklarojë të hapur i zoti i shtëpisë, 85 vjeçari Gjak Lulash Vuksani, i cili në pamjen e pare të jep përshtypjen se akoma nuk i ka mbush të 60-tat, falënderoi pjesëmarrësit për nderin e madh që i bëhet familjes sonë. Duke ju uruar dasma e gëzime paçi në familjet tuaja. Trokitja e gotave me urimet Gëzuar fillojë dasma.

Të gjithë ishin të gëzuar e veçanërisht fëmijët, të cilët ishin të shumët. Kishte të moshuar në vite, por të ri në mendime. Bëhet fjalë për axhën e dhëndrit, Mhill Vuksani, i cili po ju afrohet të 90 –tave. Prania e tij e hijeshojë dasmën. Lokali i dasmës ishte zgjedhur nder më të mirët që ka veriu i Shqipërisë, Restorant “DI-ADEMA”. Mjedisi dhe kuzhina ishin pjesë e kësaj atmosfere. Ndonëse thonë se në botë fliten rreth 7000 gjuhë, pa ekzagjerim themi se në këtë dasmë fliteshin mbi 15 prej tyre. Dasma vazhdonte dhe urimet dihen janë për çiftin simpatik të trashëgohen. Por urime pati për të gjithë familjen e fëmijët, nipa e mbesa dhe stërmbsa të Gjak Vuksanit e të Bardhe Tomes. Po të kthehemi në retrospektiv kujtojmë në të kaluarën zhvillimi das-

mave ka pas rite e rituale të ndryshme, ku secili veprim kishte një simbolikë. Në këtë dasmë duket se janë harmonizuar tradita me modernen.

Ka ndryshuar edhe koha e dasmave. Dikur ishte stina e vjeshtës për dasmat; ndërsa tani falë ardhjes se emigranteve, dasmat bëhen në verë. Dasma vijon, çifti e të pranishmit këndojnë e vallëzojnë. Orkestra nuk pushon me këngë folklorike, të muzikës së lehtë, klasike dhe këngë nga vendet pjesëmarrëse në këtë gëzim. Flamujt e të gjitha vendeve nga është origjina e pjesë marrësve, valëvitën në duart e fëmijëve të udhëhequr nga djali, Karlo Gjon Vuksani.

Qëllimi ishte kuptim-plotë. Të ftuarit nga vende të ndryshme të ndihen si në dasmat në vendet e tyre. Karlo, Nikoja e Leonardo janë angazhuar në maksimum, duke ndjekur çdo gjë, që dasma të shkojë sa ma mirë dhe qëllimit ja arritën. Duhet të theksoj se ekziston një thënie “Kush ka qenë është e do të jetë!” Kjo vërtetohet edhe nga familja e Lulash Males në Lekaj, e njohur në Shalë, në Dukagjin e më gjerë. Shpresat janë se brezat, që rrjedhin nga kjo shtëpi, traditat e mira po i çojnë gjithnjë e më përpara. Ky brez i kësaj familje

arriti të hyje në Evropë. Në bisedat e zhvilluara me këta emigrant, një pjesë madhe thonë se sa të përfundojë infrastruktura, fjalën e kanë për rrugën Prekal – Theth dhe zyrtarizmi i regjistrimit të tokës sipas kufijve të vjetër, do të kthehemi e të investojmë me të ardhurat e siguruara në perëndim. Vëllezërit e lartë përmendur e kanë seriozisht, pasi me fondet e tyre e kanë çuar rrugën e makinës në Qetë të Lekajve.

Le të kthehemi te dasma, pasi në kohën që po bëjmë këto biseda, ajo vijon më e zjarrtë e më fuqishme. Krahas urimit për çiftin, pati urime edhe për këtë familje, që na mundësoi të takohemi, se kishte nga ata që nuk ishin takuar edhe me vite të tëra, duke qenë të një gjaku.

Në fund, kur përfundoi dasma, aty nga ora 04.00 të datës 11 gusht 2024, i themi Gjak Vuksanit e familjes tij: “T’u rrit ndera dhe gëzime paçi gjithmonë!

Çifti u gëzoftë, u lumnoftë dhe u shumoftë!

*Përgatiti, Ndue Ziçi,
11 gusht 2024*

◀ karakteristikat themelore të tij, një kat të përbërjes së tij apo e disa kateve që do t’i shohim vetë, të një sistemi apo të një dukurie të veçantë.

Parametrat e përcaktojnë natyrën apo gjendjen ose regjimin e punës në një drejtim. Ajo na i ruan të pandryshshme kushtet e mira të një mësimi të dhënë përmes dioptrisë së të vërtetës së tij, që është në fakt një paramendin i tij nga sasia e madhësisë së tyre, që ruan edhe vlerën e tyre në tërësi.

Në rastin e Prend Ndue Buzhalës, i kemi të vërtetat e shikuara e të thëna përmes shkrimeve metaforike në katër vepra të tij, poezi e prozë të shkurtër, të dimensioneve të tij letrare. Një pjesë të tyre, po i përmbledhim, si vijon:

- Si dimesion i parë padiskutim është postmodernizmi i tij. Kush nuk i ka lexuar veprat kritike dhe të teorisë letrare, edhe ndërkombëtare, si p.sh. Mario Androtti, “Die Struktur der modernen Literatur / Struktura e letërsisë moderne”, botimi i 4, Haupt Verlag, Bern-Stuttgart-Wien, 2009, ose veprën e Linda Hutcheon “Poetika e postmodernizmit / Hitoria, Teoria, Fiksioni”, OM, Prishtinë, 2013, e të tjera si këto, këtë dimension letrar të shkrimtarit të nderuar Prend N. Buzhala, nuk mund ta dijë tekstualisht ta thotë lexuesi i thjeshtë. Postmodernizmi e ka shprehjen e vet që prej vitit 60 të shekullit XX. Kjo letërsi, pas Luftës së Dytë Botërore (LDB-së), ka përfunduar në këtë periudhë. Filimi i subjektivitetit të letërsisë së viteve të 70-ta ka fizionomi të re nga letërsia klasike të viteve të 60-ta. Postmodernizmi i letërsisë së viteve të 80-ta dhe të viteve të 90-ta fillon me intertekstualitetin. Prend Ndue Buzhala punimin e parë e ka botuar me 1967, ndërsa vepra e parë e tij, që ne po e cekim tani, është rezultat i postmodernizmit të intertekstualitetit, në poezinë e tij dhe veçanërisht në tregimet e shkurtëra. Pas viteve 2000 e përfshin modernizmi i

ri, prej postmodernes, në vitin 1980. Vepra e parë, me lirikë shqiptare, “O Amë, o Amë”, botim i Klubit Letrar “Vorea Ujko”, në Klinë, është botuar në vitin 1995, gjysma e postmodernizmit, kur fillon modernizmi i ri. Pra, veprat e tij përfshihen në modernizmin e ri, pas viteve 1995, në përgjithësi, të letërsisë shqiptare. Intertekstualizmit të tij po i kushtohet vërtetë rëndësia e dimensioneve letrare.

- E dyta, janë ngjarjet simbolike dhe alegorike të tij, të marruara nga realiteti ynë dhe me dinamikë të përgjigjeve të intertekstualitetit në formën më adekuate të metaforikës, nëpër periudha të ndryshme, përderisa nuk dimë t’i qëndrojmë besnik dhe për vije ndërgjegjes sonë dhe me vetëdije të plotë kombëtare e të dalim njëherë për njëherë prej copëtimit të trojeve të atdheut shpirtëror. Duhet të mos shkojmë më symbylltazi e pavetëdije nëpër ndarjet tona eventuale, nëpër sakrifica të mëdha të kombit tonë.

Ne, nuk jemi të vetëdijshëm, aq sa duhet të ishim, e të mos ia lëmë këtë punë rretheve ndërkombëtare të na rikthejnë të padrejtën mbi ne, të armiqve të shumë edhe më të rrebtë, se sa kanë qenë më parë, në shpërfilljen tonë.

- E treta, liria ka lindur në i-lirishte dhe gegërishte, si të parat këngë, dhe në një vepër të lirikave ilirishte “Ani i ilirishteve”, të cilën e kam zgjedhur më tipikën për ta analizuar në tërësi, sepse ilirët/yllorët/gegët nuk e thonë këtë asnjëherë, por janë të parat që kanë sunduar njerëzimin, në Egjipt.

Këto vinë nga superiori ilirik, e na janë kryesisht lirika të tilla atdhetare të karakterit kombëtar ilire, arbane apo arbërore, prej Zotit të parë THOT e Zotit NJË në fenë e krishterë katolike, nga ANI i vërtetë krijues. Këto janë këngë tipike kombëtare e gegërishte, edhe kur i ngjeshin ato tema të reja nëpër këngë ilirishte në kuptimin e fjalës së shkruar artistikisht e poetiki-

sht, të pashkruar asnjëherë më parë nga shpirti ynë krijues, të koncetruara nga Bibla e Vargjeve, që janë këngë të bukura e të mirëfillta i-lirike.

-E katërta, tregimet me pak fjalë janë vija e dytë e tregimeve dhe e para në letërsinë shqiptare, që trajtojnë plot figura artistike, të ironisë e ndonjëherë të sarkazmit, realitetin e hidhur prej antikitetit të lashtë e deri në kohën tonë. Është jeta enigmatike që na shprehet e na shpaloset shkurt e trup, nëpër krijime të shkurta letrare, siç i quan shkrimtari ynë “tregime, me pak fjalë”.

- E pesta, zhanri letrar i prozave të shkurta dhe simbolike e alegorike, me figura të ndryshme të fjalës së shkruar artistike, është metaforika, që nuk quhet kështu në shkencën letraro-historike apo teoriko-letrare, që janë prej të gjitha figurave letrare, prej ironisë e deri te sarkazmi i hollë.

Në fakt, janë në bazë të përjetimeve letrare e të fatit tonë të hidhur, deri te shpalosja e tyre artistike.

- E gjashta, çështja e besimit është çështje individuale dhe ka të bëjë vetëm me psikologjinë e njeriut. Besimi është çështje e trurit dhe egos, nuk është çështje e përkatësisë kombëtare. Edhe njëherë po e themi se vjen në radhë të parë të gjuhës së folur, pastaj të shkruar; të simbolit kombëtar; të shtrirjes së tij nëpër një territor të caktuar, pa marrë parasysh se cilit besim i ndërliidheni apo asnjërit nuk i ndërliidheni e jeni pa relegjion të caktuar; të tregtisë e rrjetit të marrëveshjeve të përditshme, ku bukës i thonë bukë, e ujit i thonë ujë. Çështja kombëtare është çështja e parë dhe e parevokuar nga shqiptarët. Është çështje primare, e jo sekondare! Çështja kombëtare i konvenon çështjes gjeo-politike, e jo çështjeve të tjera, si të dorës së dytë. A beson në këtë fé apo atë fé, apo në asnjërin, kjo nuk të sjell kundër njëri-tjetrit. Përkundrazi. Larushitë e ru-

ajtura në fund të shpirtit tuaj, me bukurinë e papërshekruar nëpër risitë e dhëna përmes fesë, janë dhunti e veçantë e tyre, të dhëna me gjuhën e pasur letrare shqipe. Të jesh ilir e shqiptar nuk do të thotë se e ndërron gjakun e damarëve tuaj kur quhesh në baza fetare. Dihet, i shtati njeri përcjellës i Jezu Krishtit ka qenë ilir: Nika, Nikolla. Janë quajur ar-ban dhe kushërinj të tyre ishin armaikët e armenët, tre fiset në Lindjen e Mesme e të Vogël. Në bazë të gjuhës jeton dhe dallon kombi, me të dy etnitë: gegët dhe toskët. Në radhë të parë duhet të jenë të bashkuar ata, në tokën e Atit (Ati jonë, atdheu, mëmëdheu!). Kjo tokë, e ruan gjuhën tonë, gjuhën shqipe, prej tokës që quhet tokë shqiptare. A bëhet që të jetojmë si skllevër, në tokën tonë të copëtuar, me vuajtjet e Sizifit, pa gurin e tij? Jo! Kjo nuk është e saktë! Kjo nuk është e drejtë! Kjo është çështje e dëshirës së KRYEDEMONTIT! Ajo duhet të jetë një çështje e Zotit të Madh!

- E shtata, mitologjia (e mirë apo më e dobët, e zhvendosur nëpër kohë të ndryshme dhe nëpër vende të tjera!) zë vendin kryesor në dimensionet letrare të Prend Ndue Buzhalës. E thotë apo nuk e thotë këtë gjë autori i tyre, qoftë edhe për titujt e tyre, p.sh., “Sizifi pa gurin e tij”, ajo na është pjesërisht apo tekstualisht nëpër tregimet e shkurta, deri në Egjipt e para saj. Koha që e përshkruan këtë popull e këtë komb të veçantë, është realiteti ynë jetik!...

Ka edhe të tjera, por unë i ndava me kaq. Po e lë, me kaq! Shtatë palë janë edhe për Zotrat. Tre i numërojmë ne, Zotin e Madh, Babën e Nënë!

Zotin e Madh nuk e shohim, por e ndjen ZEMRA! Metafizikën e njoh mirë para KRIJIMIT! Trinia është e veçantë e përkushtimit krijues të Prend Ndue Buzhalës. Jetoftë edhe shumë vite e lashtë pas tij edhe shumë vepra!...

TRE DEPUTET TË NJË SHTEPIE

Mbledhja e Kuvendit Kushtetues Kombëtar 1943

Çdo kohë ka fytyrën dhe identiten e saj që nuk ngjason me një tjetër. Kuvendi Kombëtar Kushtetues i quajtur edhe Asambleja Kushtetuese (u krijua pas kapitullimit të pa nderë të Italisë fashiste dhe ardhjes së forcave naziste gjermane). Strategjia gjermane ishte t'i qetësojë dhe përvetësojë shqiptarët, t'iu lejoi që këta të formojnë strukturat e veta për të gjitha nivelet e një pushtetit bashkëpunues me ushtrinë naziste gjermane. Besimin më të madh e kishin në kuadrat udhëheqëse politike nga Kosova. Në këtë kontekst përfaqësuesi kryesor për Ballkanin, Dr. Hermann Neubacher, i thirri në një takim në Beograd (më 6 shtator 1943) Xhafer Devën dhe Vehbi Frashrin, i biri i Mehdi Frashërit. Mehdi Frashëri ishte një antifashist i dëshmuar dhe për këtë arsye ishte internuar në një kamp në Itali, bashkë me shumë intelektualë tjerë antifashistë. Neubacheri ua kishte bërë me dije Devës dhe Frashrit kapitullimin e shpejtë të Italisë dhe nevojën e një organizimi për të mos lënë hapësirë për kaos.

Xhafer Deva i kishte propozuar formimin e një komiteti ekzekutiv të përkohshëm për t'u marrë me menaxhimin e situatës deri në formimin e organeve përkatëse. Për këtë qëllim Deva nga Beogradi shkon në Shkodër (më 8 shtator), ku informohet përfundimisht për kapitullimin e Italisë.

Neubacheri shkon në Tiranë më 10 shtator 1943. Ai u premtoi shqiptarëve: rivendosje të pavarësisë, qeverisje plotësisht të pavarur, pa u përzier ushtria naziste gjermane në punët e strukturave civile shqiptare, garantimin e kufijve etnikë që ishin krijuar, brenda të cilëve përshiheshin 74 000 km katrore toka të banuara me shumicë shqiptare. Krahas punëve tjera vijuese, Komiteti Ekzekutiv bëri përpjekjet për zgjedhjen e delegatëve për Kuvendin Kombëtar, të cilin e kishte caktuar për 16 tetor 1943. Delegatët duhet të zgjidheshin nga secila prefekturë, nënprefekturë, komunë a bashkësi e tokave të bashkuara të Shqipërisë etnike, sipas rregullave dhe kriterëve të caktuara. Meqenëse në kushte të luftës, nuk ishte e mundur të zhvilloheshin zgjedhje normale e delegatëve nga çdo prefekturë, Këshilli Ekzekutiv ishte autorizuar të caktonte përfaqësues nga radhët e personaliteteve të shquara dhe nga radhët e klerit dhe bajraktarëve të Malësisë.

Mbledhja e parë e Kuvendit Kushtetues Kombëtar i filloi punimet më 16 tetor 1943, në Pallatin Mbretëror në Tiranë, në të cilën morën pjesë 187 delegatë. Kryesues të mbledhjes së Kuvendit u caktuan Lef Nosi (kryetar) dhe Xhelal Mitrovica (sekretar). Numri më i madh i delegatëve ishin nga Kosova dhe nga Dibra e Madhe. Delegatët nga Kosova, të veshur me rroba kombëtare dhe jo pak prej tyre edhe të armatosur, kishin arritur në Tiranë në mënyrë të organizuar, me tre aubobusë. Kur delegatëve të zgjedhur iu bashkuan edhe 57 veta nga personalitetet e caktuara nga Këshilli Ekzekutiv, numri i pjesëmarrësve në Kuvend arriti 244 veta.

Bek Delia, Lulash Gjeloşi e Zef Delia ishin tre deputetët dukagjinaz të **Kuvendit Kushtetues Kombëtar. Dukagjini u përfaqësua si kurrë ndonjë here me parë as më pas. Dukagjini u përfaqësua me tre (ulje) në sallë. Është rasti i vetëm unik në historinë e Parlamentit tone e ndoshta shumë, shumë me gjerë ku tre deputetë vinin nga një derë, dera e Beke Delisë, me nr. rendor 31, Lulash Gjeloşi me nr. 107 dhe Zef Delia, me nr. 200.** Kuvendi ka ngjyrën dhe vullën e kohës dhe ishte produkt i kohës së turbulencave të tmerrshme të luftës Më 18 tetor 1943 nga një kodër afër Pallatit Mbretëror në dalje të Tiranës, komunistët antifashist e brigadës së 3-të (e cila ishte formuar më 9 tetor 1943 në Arbanë, Br3S) e patën goditën me top selinë e Kuvendit Kushtetues.

KUSH ISHIN KËTA TRE DEPUTET?

Bekë Delia, furtuna antikomuniste!



Bekë Delia, i ri energjik me teparamet me të rrëmbyer si Drini, në vjeshtën e trete antikomunisti më radikal, më i guximshëm e më spektakolarë i maleve të Dukagjinit.


Beka njeri prej 5 djemve të Deli Marashit, prijës i Shoshit në kryengritjen kundër Turgut Pashës në viti 1910 dhe malazezve në vitin 1915 Gjatë viteve të okupacionit ishte kundra Frontit Antifashist. Pas çlirimit të vendit ka qenë një ndër të parët shoshianë që u aktivizua si nëpunës i lartë në administratën e re të Rrethit të Dukagjinit. Bekë Delia së bashku me Prelë Markun e Pecajve në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 kanë qenë Nënkretar Elektoral të Zonës nr 11, zonë në të cilën deputet u zgjodh Profesor Kolë Prela.

Me 24 gusht 1946, shefi i Seksionit të Sigurimit të Rrethit të Dukagjinit, kishte marrë urdhër për të shoqëruar për në seksion Lekë Vojvodën dhe bajraktarin e Shoshit - Lulash Gjelošin. Si eksponent me influencë të forcat kundërshtarë të regjimit të ri dyshohej se mos do të hynin në lidhje me reaksionarët (quheshin ata që nuk pajtoheshin me shtetin e ri), prandaj u morën për t'iu izoluar. Nga ana tjetër, Lulash Gjeloşi duke qenë se ishte i sëmurë e hipën në një mushk dhe po e çonin atje ku kishte thënë Xhemal Selimi. Skena e shoqërimit të Lulashit për në seksion irritoi në ekstrem Bekë Delinë, i cili sa u përball me shoqëruesit qëllor dhe vrau tre ushtarët e shoqërimit dhe më pas

së bashku me mixhën Lulash arratiset në mal. Ky veprim, që bombë ofensive me pasojë fatale që çoj në shpërthimin e një zjarri luftarak mes të dy palëve, që tashmë nuk kishin më as një kompromis vetëm likuidimin e të mundurit. Po atë ditë forcat e ndjekjes hakmerrën duke vrarë Kokërr Kolën dhe djegë shtëpinë e Deliut dhe të Lulashit me gjithë çka pati. Kështu spontanisht filloi konflikti i gjatë i Bekë Delisë dhe i meshkujve të tij me shtetin komunist që përfundoi me një bilanc shumë tragjik mes dy palëve antagoniste. (Kokërr Kola, Ndue Delia, Kolë Marashi, Mark Delia, Pal Delia, Bekë Delia nga njëra anë dhe po kaq edhe më shumë nga pala e forcave të ndjekjes).

Bekë Delia shkaktoi panik tek forcat e ndjekjes. Ai ishte mjeshtri i pritave dhe i zhblokimit të rrethimeve në Balëza, Bualli, Çija të Palajve, Mal të Shoshit, Bjeshkë të Lotajve, Zeletinë e të tjera. Me bëmat e tij të përgjakshme u bë legjendë në popull dhe shumë i kërkuar misterioz i qeverisë. I betuar se nuk do të dorëzohej kurrë, u vra në përpjekje me ish forcat e ndjekjes në 25 nëntor 1946 në Bjeshkët e Lotajve. U vra pasi kishte korrë koka të forcave të armatosura të pushtetit, Në Pylle të Shoshit, Karmë të Palajve, Bjeshkët e Lotajve dhe në Mal të Shoshit. Will dhe Ariel Durant, dy prej mendimtarëve më të shquar të kohës sonë janë shprehur se mësimi i parë biologjik i historisë është: "Jeta është konkurrencë dhe se lufta është mënyra e të ushqyerit të një kombi". Mësimi i dytë biologjik i histories, është se "jeta është seleksionim, konkurrencë për ushqim, çiftëzim ose pushtet". Lufta e komunisteve dhe antikomunisteve ishte luftë për pushtet ku secila palë proklamonte modelin e vet. Ajo palë që ka pushtetin bënë drejtësinë dhe historinë.

Lulash Gjeloşi



Lindi në vitin 1883¹, burrë me inteligjencë të lartë natyrore, kryetar karizmatik i fisit të papërzier të 300 shtëpive të Shoshit, të cilin e drejtoi me grusht të hekurt.

Ai besonte në fisnikërinë e ligjeve doksore të maleve të tij, prandaj jetoi deri në vdekje si rojtar i Kanunit. Qe ndër përfaqësuesit më tipik të breznisë së fundme e të pafat të bajraktarëve të maleve tona. Njeri praktik, i shkolluar me librin e jetës, që e kishte mësuar se kyçi i suksesit ishte

¹ AQSH.Fondi 374 dosja nr 3 viti 1933. Sipas statistikës së lindjeve të Komunës Nicaç, Shosh

kombinimi i forcës me inteligjencën. Ndonëse pa shkollë kishte nuhatje dhe ambicje politike më të lartë se të gjithë kolegët bajraktar të kohës së tij. Lulash Gjeloşi është një figurë komplekse me dritë - hijet e veta, produkt i kohës që jetoi. Libardi thotë se, në vitet e rinisë mori rrogë në policinë osmane së bashku me djalin e bajraktarit të Shalës ndonëse nuk shërbeu asnjë ditë².

Ka qënë prijës i Shoshit në qendresën historike anti - malazeze në Qafën e Boshit 1915³. Me 17 Nëntor 1919 ka qënë një nga organizatorët kryesor të mbledhjes së Kuvendit të Prekalit, që thirret ndryshe edhe "Besa e Prekalit"⁴ (Shalë - Shosh - Postribë - Nikaj Merturë - Krasniqe - Gash)

Me 6 mars të vitit 1920 është një nga 72 nënshkruesit (krerë) e Vendimit të Komitetit të Shkodrës për mbrojtjen e atdheut⁵. Në qershor të vitit 1925 mori pjesë në kongresin e bajraktarëve dhe të krerëve të malësive të Veriut, të cilët shkuan në Tiranë dhe u takuan me Ahmet Zogun pas rivendosjes së legalitetit. Brenda një kohe të shkurtër ndryshon totalisht kursin, duke u bërë një nga frymëzuesit e Lëvizjes Antizogiste të Dukagjinit të Nëntorit 1926 të dirigjuar nga Dom Loro Caka, Ndokë Gjeloşi, Vas Kiri e të tjerë⁶. I dënuar me vdekje në vitet njëzet nga Zogu dënohet serisht në mungesë nga gjyqi politik i marsit 1927 dhe fiton pafajësinë me 28 shtator 1927 së bashku me 64 dukagjinaz të tjerë⁷.

Lulash Gjeloşi dhe kolegete e tij bajraktare, kleriku rebel Dom Loro, Vas Kiri dhe Ndoke Gjeloşi janë përgjegjës të një lufte që nuk duhej të kishte filluar tafti-bafti dhe përfundoj në një tragjedi të tmerrshme.

Me 24 tetor 1937 është një nga eksponentët kryesor të mbledhjes së gjithë parisë rajonale të Nënprefekturës së Dukagjinit (36 nënshkrues). Mbledhja filloi nën kryesinë e të deleguarit të shkëlqesit të tij Ipeshkvit të Dukagjinit Benardin Shllaku, Padër Rrok Gurashi, tuj pranue si sekretar z. Asim Bekasin -Mbas një diskutimi të gjatë mbledhja unanimisht pranoi e vendosi pikat e poshtëshnueme: - Festat, gjamët, dasmat.

- Ndalimi i fejesave pa mbushë moshën 15 vjeç. Sheji i fejesës (Kapari)

- Gruēja e ve mbas dekës së burrit - Rumja e famujve

Buka dhe përgimi (rast lindjesh) asht e ndalueme.

- Lamja e duerve e tasit dhe ibrikut të rakisë.

- Rrahja ashtë e nalume⁸.

Si kundërshtar i papajtueshëm i regjimit të Zogut dhe ithtar i Shqipërisë Etnike së bashku me disa eksponent antikomunist

² K. Libardi Lëvizjet e para patriotike shqiptare, 1910,11-12, fq 77.

³ Z. Doda "Kulla e Zjarrtë", bot i vitit 1999, fq. 29

⁴ Gazeta "Populli"Nr 42 viti 1919.

⁵ Zef.M.Harapi."Historia dhe Etnografia e Dukagjinit".Studim 1940.A.M.H.Shkodër, fq. 210,211

⁶ AQSH, F 152/9, v.1926, D. 5/2, fleta 109.

⁷ AQSH Fondi 346;viti 1926. Dosja 67.

⁸ AQSH.F.374. VITI 1937..Dosja nr 2 fleta 1-4

me influencë të veriut si Ndoc Pistulli, Sylçe Begu (Shkodër), Gjon Marka Gjoni (Mirditë), Kolë Ndou (Shalë), Kolë Bibë Miraka (Iballë) e të tjerë firmosin për përzenjën e matjanit nga fronti, për t'i hapur rrugë ardhjes së dinastisë së Savojës⁹, që pak kujt aso kohe i shkonte mendja. “Me 5 korrik të vitit 1939, Mëkëmbësi i Mbretit, Perandor Galeaco Çiano pati bërë një vizitë në Shkodër dhe më pas në Theth. Vizita në Theth u trumbetua se u bë në shenjë nderimi ndaj martirëve antizogist të Dukagjinit të vrarë nga diktatura mbretërore. Vërtetë spektakolare dhe surprizuese ishte edhe pritja që iu bë Çianos në Theth, i cili erdhi i shoqëruar nga ministri me gjak dukagjinat, Ernest Koliqi, Pater Anton Harapi, Kolonel Ndokë Gjelooshi. Pjesëmarrja ka qenë masive nga gjithë Dukagjini, ku spikasin paria, krerë, bajraktarë, burra kanuje, djelmi, gra dhe vajza, pleq e femijë.

“Mëkëmbësi dhe Dora Maja u shtruan në drekë malësore. Grupe dukagjinatish këndonin këngë të vendit, në të cilin binte në sy lahutari Gjergj Pëllumbi. Një grup nxënësish këndonte me zotësi të dukshme dhe të tjerët gëzonin dhe festonin. Lulash Gjelooshi, një përfaqësues i fiseve qindrvajçare të Dukagjinit, në mes ovacioneve i dhuron Çianos një kopje të kanunit të Lekë Dukagjinit”¹⁰. Më pas Çiano deponon një kurorë në varrin e fatosave që dhanë shpirt në litarin e Zogut mars 1927 dhe mbahet një minutë heshtje për kujtimin e martirëve. (E çuditshme, por duhet pranuar se kjo kurorë ishte e para dhe fundit e vendosur ngandonjë eksponent i politikës qoftë vendas, qoftë i huaj në nderim të antizogistëve dukagjinat, nënvizimi im P. M).

Lulash Gjelooshi ka qenë në dijeni të aksionit intervenues anti-italian të ushtrisë jugosllave në territorin e Dukagjinit dhe të Shkodrës, në prill të vitit 1941. Me porosi direkte të Ernest Koliqit ka marrë një sasi armatimi të kufizuar për të furnizuar vullnetarët e zonës së tij si masë kundërgoditëse ndaj forcave jugosllave. Gjithsesi duhet vlerësuar qëndrimi i drejtë i Shoshit dhe Dukagjinit, të cilët nuk u bënë palë të një luftë të pakuptimtë italo-jugosllave, që u zhvillua si pasojë e konjukturave ndërkombëtare në territorin e tyre. Përceptimi i paparashikuar i ngjarjeve solli një qëndresë krejtësisht spontante në Gurin e Kuq, në kufirin ndarës mes natës dhe ditës së 22 e 23 prillit 1941¹¹.

Lulash Gjelooshi gjatë viteve të okupacionit pozicionohet hapur si kundërshtar i deklaruar i FNÇ dhe PKSH, megjithatë në prak të çlirimit i hodhi ujë zjarrit, në kundërshtim me vullnetin e atyre që kërkonin të imitonin aventurën e Qafës së Kolçit edhe në Shosh e Shalë. Në vitin 1943, së bashku me të kushërinin Zef Delinë dhe Bekë Deline rezulton të ketë qenë deputet i “Asamblesë Kombëtare (Kuislinge)”¹². Është fjala për Asamblenë Kombëtare (e ashtuquajtur Kuislinge), që funksionoi formalisht në kohën e okupacionit. Menjëherë pas çlirimit nga frika e hakmarrjes së komunisteve del në mal ku qëndron i arratisur për tre muaj dhe me ndërmjetësinë e Profesor Kolë Prelës

dorëzohet dhe lihet i lirë me gjithë armë së bashku me Mark Sadikun, Sadik Markun, Kol Nduen, Nikë Gjelooshin, Gjeloosh Bajraktarin, Sokol Balën, Mark Vuksanin e të tjerë¹³. Në shkurt të vitit 1945, së bashku me Kolë Nduen, Kadri Pejën dhe 22 krerë e bajraktarë të Veriut të Shqipërisë, takohet me Kryetarin e Qeverisë, Enver Hoxha! Radio Tirana atë ditë në emisionin e saj të lajmeve njoftonte: “Kryetari i qeverisë, priti krerët e malësisë së veriut, me të cilët zhvilloi një bisedë të përzemërt e shumë miqësore, ndërsa këta shprehën mirënjohjen e mbarë popullit të maleve të Shkodrës ndaj Gjeneral Kolonel Enver Hoxhës” Ky fakt vërtetohet edhe nga deponimet e Gjeloosh Lulashit në hetuesi, me datën 17 janar 1946 “¹⁴... Mbasi na la (Lulash Gjelooshi) shkoi bashkë me bajraktarin e Shalës e disa të tjerë u takuan në Tiranë me Komandantin e Përgjithshëm¹⁵.

Me 21 qershor 1946, Shefi i Seksionit të sigurimit të rrethit të Dukagjinit, Xhemal Selimi, së bashku me një patrullë ushtarësh, marrin për t'i shoqëruar në gjendje të lirë për në seksionin e hetimit, Lulash Gjelooshin dhe Lekë Vojvodën¹⁶. Duke dyshuar se do të arrestoheshin më pas, Lekë Vojvoda i ikën nën hundë Xhemal Selimit, ndërsa Bek Delia po për të njëjtin dyshim vret tre ushtarë të forcave të mbrojtjes, që shoqëronin Lulash Gjelooshin. Pas këtij konfrontimi të beftë, arratiset së bashku me gjithë mashkujt e rritur të shtëpisë së tij. Konflikti që me pasoja thellësisht tragjike për të dy palët ndërlyftuese. Vetëm nga kjo familje humbën jetën 14 veta (vra në përpjekje, vdekur në burg dhe në kufi, duke u arratisur dhe po ushtarë dhe forca të sigurimit në vitet 1946-1947)

Me 29 nëntor 1946 shpallet një amnistia ku u falej jeta të gjithë atyre që nuk kishin larë duart me gjak. Lulash Gjelooshi, së bashku me meshkujt e vet të mbijetuar dorëzohen në qendrën e rrethit Kodër-Shëngjergj. I vetmi që nuk përfitoi nga amnistia ka qenë Bekë Delia, i cili u vra në përpjekje me forcat e sigurimit. Major Zoj Themeli, Shefi i Sigurimit, kur e pa Lulash Gjelooshin të molisur nga mosha, sëmundja dhe vuajtjet e pyeti me një ironi tepër ofenduese: - “A kënge gjallë, moj kermë?! Të paktën a je pëndue për gjithë ato që na kanë bërë njerëzit tuaj mbi partizanët? A e din se sa na janë dhimbtë ne ata?!”. - “Pasha bukën sa të janë dhimbtë ty, aq e ma tepër më janë dhimbtë mue mashkujt e mi që mi ke vra”; - iu përgjigj Lulash Gjelooshi.

Zoti e din sa keq kam hjekë me i rritë e ma kanë tha zemrën. Për mue mos ki gajle kur do des, veç një gjë kam me t' thanë: Mjerë ata që kanë ba keq në këtë jetë!”¹⁷

Lulash Gjelooshi u dënua disa vite burg, por i lodhur nga vuajtjet mosha dhe sëmundja vdiq në burg.

Zef Deilia, heshta e heshtur!

Kishte një hije burri gatue me brumin ma të mirë të magjeve të maleve tona, mustaqet dy kurmash jo të harlisura, sytë si shqipe, vetullat e harkuara gajtane, flokët e qethur shkurt strukur nën kapuçin e bardhë. Koburën dorë argjend



nën shokën, që i stoliste brezin përmbi tirqit me shajak të bardhë spik korb. Ishte nishan i njeriut të njerëzishëm të thjeshtë, fjalë pak dhe të sakte Kudo mblidhej kuvend i lëshohej vendi dhe fjala i dëgjohet me respekt. Lahutës i kishte ra në rini edhe në kohë të burrnimit nuk e kishte harue dashurinë e vjetër. Duke qenë i biri i homerikut të vjetër, Deli Marshit, gjithë jetën pati një barrë të rënë mbi shpine, që nuk e la rehat të bënte atë që vrulli dhe entuziazmi rinore shpesh here të rrëmben drejt aventurave të moshës. Pa prite e pa mendue që i detyruar të merrte malet. Lufa me qeverinë kishte filluar sakrificat dhe flijimet ishin të pa shmangeshme. Jetën e malit me plot rreziqe, ndeshje drama, sakrifica dhe flijime si as kush e përjetoi barku Delisë. Tata i vjetër i pa thyer nga turqit dhe malazet, në vite e moshës së tretë ngjeshi prapë martinen kundër regjimit komunist së bashku me të gjithë djemtë dhe nipat e tij, Zef Delia, Çun Delia, Marash Delia, Ndue Delia, Mark Delia, Kolë Marashi, Gjin Marku, Gjon Marku, Kolë Marashi, Beke Delia (Kokerr Kola, ishte vrarë në mbrojtje të shtëpisë, me 22 qershor 1946). Zef Delia, që ishte burrë i prerë i fjalës, të cilën kur e jepte, vdiste e së bënte më dysh. Njeriu besnik nuk ka nevojë të bëjë lajka, pasi ai zotëron një kapital të patundshëm siç është besnikëria. Zef Delia mori pjesë në Luftën e parë Zeletines në qershor 1943 në territorin e Plavës dhe Gucisë. Forcat të perbashkta nacionaliste shqiptare malazeze luftuan kundër forcave antifashiste (komuniste) Jugosllave. Ishte përkrah Kole Ndout të Pecajve, Lulash Gjelooshit, vëllait Marshit, nipit Gjin Markun dhe një armate dukagjinase afër 80 veta¹⁸. E tmerrshme si nata, e ftoftë si akulli dhe përgjakshme si mordja që lufta e Dyte e Zeletinës, në dimrin e tmerrshëm të viteve 1943-1944. Në këtë luftë mbeti vrare shoku dhe bashkëluftëtari i tij, Zef Toma i Brashtës së Shoshit.

Zef Delia ka qenë protagonist i ndeshjeve më të përgjakura me forcat e ndjekjes dhe sigurimit, me 20 gusht 1946, në Balza të Shoshit, ku mbetën të vrarë Kolë Marshi dhe Mark Deli Marshi e plagoset rëndë Marash Delia, ndërsa Zefi lëndohet duke çaluar si dre i plaguar nga bishat. Zefi Dela mrekullisht i shpëtoj breshërisë të stuhishëm të plumbave në

¹⁸ Eduart Çurçia Flamurtaret e Shoshit nder breza, Botim i viti 2012 .fq. 91

Mal të Shoshit, por jo vëllai i tij trim Ndue Dela, Mark Delinë e puthin plumbat, por nuk e ndalin. Ndeshjet vijuan në Çia, Mollë Bualli, Cukal. Guri i kuq, Kodër Shëngjergji, Prekal, Postrisë e të tjera. Zef Delia ka qenë mirënjohës popullit të Shoshit, që iu bënë krah në arratinë e tij koçake, në strehimin ushqimin e deri në vete flijime martire. Nja nga strehët më të sigurta dhe më të besuara ka qenë Bjeshka e Molles ku Zef Marku, Zog Mala, Mark Noshi, Mark Mëhilli, Mehil Kola, Kolë Deda, Bal Pjetra, Ndue Kola (kaçak) apo emrat e shquar të Palajve Kole, Delia. Kolë Nika, Mehil Kokrri, Mark Mehil, Gjeloosh Nika Dode Pela, Lulash Bala (kaçak), Zef Ndoci Mehil Zefi Dardhe, Gjon Pepa Pepaj (kaçak), Zef Marshi Pepsumaj (Kaçak) Mehil Nika (Kaçak). Leke Vojvoda, Mark Mala, Mirash Ndou (kacakë), Prelë Pellumbi, Gjin Martini, Nikë Gjelooshi, Ndre Preka, Martin Kola, Mark Luca e të tjerë, gjithësejt 97 persona të arratisur nga Shoshi dhe krejt Dukagjini. Pas konfrontimeve të gjata gjakësore, mes forcave komuniste dhe antikomuniste, duhet thënë troç se peshorja e humbjeve ishte më e rënde nga pala qeveritare. Pas Amnistisë qeveritare armët ulën nga te dy kampet.

Deli Marshi u dorëzua e vdiq në burg, me 7 maj 1949, po ashtu edhe Lulash Gjelooshi, me 11 qershor 1949; Pjeter Marku u dënua me 30 vite burg, Çun Delia 7 vite burh, Marash Dela 7 vite burg, Gjon Mark e Dedë Lulashi nga tre muaj burg.

Zef Delia u dënua 10 vite burg. Hyri e doli burrë i regjur plot dinjitet, një emër fisnik falë pak i vuajtur por i pa përkulur, që kurë nuk u ankua as nuk rrahu gjoksin. Pas burgut punoi e jetoi, rriti një familje të denje me sakrificat ma të madhnueshme prindërore.

Zef Delia si anxa e ndryme në zgor, duroj dhe jetoi në heshtim dhe dashuri e besnikëri me Zotin. I njerëzishëm, punëtorë i mirë, shërbëtorë deri në vdekje i dokeve tona më të thukta amtare.

Zef Delia, që një heshtë e heshtur në përplasjen e madhe mes dy boteve antag-oniste, që nuk njohën as një kompromis.

PRELË MILANI



⁹ Hylli i Dritës, nr 11-12, vj. XVII, fq 501

¹⁰ Revista “Hylli i dritës”, mars-korrik 1939, fq 336.

¹¹ Shih Librin “Lufta e Çuditshme” e Gurit të Kuq 1941

¹² “Historia e Parlamentit shqiptar”, fq. 57 botim i vitit 2005 Tiranë

¹³ Sipas Kujtimeve të Lulash Sokol Uranit, 85 vjeç nga fshati Pepsumaj, prezent në këtë ngjarje

¹⁴ Gazeta “Koha e re”, e martë 23 shkurt 1945. .

¹⁵ A.MB. Dosja nr 1068, fleta Nr 54

¹⁶ . A.MB. Dosja nr 980/a, fleta nr 1

¹⁷ Pjeter Pepa “Dosja e Diktaturës”, botim i viti 2010, fq 306

LIBRI JUAJ NË SYRIN TIM!

"NË FLATRAT E MALLIT", poezi nga Vera Gjonaj

Mora shkas nga titulli i këtij vëllimi mjaft të bukur për të sjellë pikëpamjet mia mbi brendinë e librit që përmban poezi me tema të bukura dhe vargje mjaft interesante, që është libri i parë i autores Vera Gjonaj "NË FLATRAT E MALLIT", që përmbledhja më poezi, që ka për autore vajzën Kuksiane, nusen Malësore dhe intelektualen emigrante znj. Vera Gjonaj.

Ky është libri i saj i parë, në të cilin ka përfshirë poezi të shkruara ndër vite, të ruajtura në shpirt dhe fletore për t'i sjellë sot para jush, por me maturi e pjekuri poetike.

Gjithmonë kam besuar se në shpirtin e secilit nga ne ka një engjëll poetik.

Shpirti poetik i secilit nga ne bashkëjeton me virtytet dhe dhuntitë tona, pastaj se kush lulëzon në jetë kjo varet nga rruga e jetës tonë.

Askush kur shkruan, kur flet apo argumenton nuk e fsheh dot botën e tij të brendshme. Poezia është muzika e shpirtit, prandaj çdo poezi është e bukur sikurse çdo lule është e bukur në pranverë.

Në flatrat e librit të saj autorja na duket si një lule, që shpërthen pas një pranvere të vonuar.

Si erdhi midis nesh poetja e re Vera Gjonaj?!

Mendoj se asgjë nuk ndodh rastësisht në këtë botë, talenti që të ka dhënë Zoti një ditë do të gjej rrugën e vet për të shpërthyer.

Autorja vjen si vala e Drinit, që ka të ngulitur në memorie Kukësin e Vjetër, ka në sy flladin e Gjallicës e në shpirt lulezambakët e Hasit dhe vargjet i ka mbledhur në livadhet e Pashtrikut. E gjithë ajo botë poetike, me të cilën u rrit Vera në rininë e saj mbeti e arshivuar në ëndrrat e saj. Them në ëndrrat e saj, sepse një tjetër ëndërr e mori si engjëll mbi krahë për ta sjellë në Malësi të Madhe. Vera Gjonaj do të bëhej nusja e Reçit, do të diplomohet në Fakultetin Ekonomik dhe do të bëhej nëna e dy djemve.

Në këto rrethana, dhe në ato vite (jemi ne kapërcyell të shekullit të ri) askush nuk do kishte kohë as luksin për një libër me poezi.

Nëse do të më duhet të perifrazoj se si ishte ajo kohë mundem të them shkurt se bilbilat braktisën bjeshkën dhe dallëndyshet braktisën fushën.

Ne pranverën e vitit 2001 edhe zonja Vera së bashku me familjen do të zhvendosej si mërgimtare në Milano Itali.

Vetë jeta është një poezi dhe poezia e jetës saj shkruhej çdo ditë diku në auditorët e shpirtit. Unë nuk do ta kisha njohur asnjëherë dhe poezia e saj do të

vijonte gjumin letargjik nëse Grupimi Ambasador të Paqes, dega për Shqipërinë nuk do ta ftonte znj. Vera në gjirin e kësaj Organizate Humanitare, për kontributin e saj në mbështetje të emigranteve Shqiptare dhe shtresave në nevojë në Itali dhe Shqipëri.

Aty në atë ambient me koleg artis,



poet dhe shkrimtarë, duket se nisi të çel gonxhet e fjetura trëndafil i saj poetic, duke pasur mbështetje të vijueshme nga koleg dhe miq të saj, ajo vjen sot me librin e parë me poezi "NË FLATRAT E MALLIT"

Si e shoh unë nivelin artistik, tematikën, mesazhin poetik dhe pse duhet ta lexojmë këtë libër do përpiqem ta shpjegoj sipas këndvështrimit tim.

Së pari, Vera në librin e saj, flet me gjuhën e dashurisë në të gjitha trajtat e saj. Herë na shfaqet e dashuruar në pafundësi, e herë e zhgënjyer në ekstrem. Shpesh na paraqitet si një manushaqe ndër ferra dhe dy-tri poezi më vonë si një vetëtimë e dashuruar, që djeg çfarëdo që i del përpara, derisa të arrijë te principi i saj i kaltër. Poezitë e saj janë të thjeshta për tu lexuar, por çdo varg përcjell mesazh. Vargu i saj bëhet interesant, kur e lejon dhe e detyron lexuesin të imagjinojë dhe ta kërkojë vetveten në poezinë e saj

Duket sikur poezia e saj është në mënyrën dëftore, sikur janë përjetime personale, por në shumicën e tyre lexuesi gjen një pjesë nga vetvetja

Autorja përshkruan brezin e saj deri në adoleshencë, atë brez, ata të rinj që për-

jetuan dy tre sisteme jetese sociale, dhe sot në pjekurinë e tyre janë si një thesare poetik me vlera.

Jam i bindur se në sirtarët e saj ka të tjera poezi më të fuqishme, sepse ajo ka një prirje të shkojë edhe më larg..

Mendoj se, autorja nuk lodhet shumë se çfarë do të thotë kritika letrare, mjaftohet të hedhë mbi letër botën e saj të brendshme.

Shkruan vargun e lire, duke përdorur rimën aty ku nuk ja cenon mendimin.

Vera, është një ekonomiste me profesion, një juriste me punë dhe një poete me shpirt, në vargjet e saj shoh ndjenjë, dashuri dhe përcjell mesazh.

Duke lexuar poezitë e këtij libri, lexoj hapur nivelin intelektual dhe formimin njerëzorë, forca e vargut shpreh thellësinë e mendimit.

Le të citojmë disa vargje nga poezia: "KJO KOHË SHTERPË"

"Aspak rehati nuk gjejmë / Këtu në vendin e shqiponjave / Me strajcën mbi supe / Vrapuam... / Vrapuam t' kërkojmë shpresën"

Titull metafizik pastaj edhe në vargje, brenga e një mërgimtari dhe sakrifica e tij.

Sa e sa janë bijtë e Shqipës, që duke kërkuar shpresën e lanë rininë rrugëve të botës. Sa më shumë, që kalojnë vitet aq më e rëndë bëhet strajca e mërgimtarit.

Duke lexuar këtë libër mendoj se çdo lexues ka kaluar një terapi, ka gdhendur diçka të re në ndërgjegje dhe në botëkuptimin e tij. Nëse mjeku është ndreqës i defekteve mekanike të trupit njerëzor, artistët në përgjithësi dhe poetet në veçanti janë mjek të shpirtit njerëzorë.

Mendoj se, poezia duhet të jetë së pari mesazh për lexuesit dhe vargjet e këtij libri kanë shumë mesazhe brenda.

Askush nga ne që shkruajmë nuk na ndodh të marrim lapsin të ulemi mbi tavolinë dhe pastaj të kërkojmë një subjekt apo një temë për poezi.

Vargu, poezia janë ndjenjë, janë pjesë e shqisave tona që vetëm ne digjmë ti gjejmë shtigjeve të universit jetësorë. Kjo më bën të mendoj se, këto poezi kanë bashkëjetuar, janë rritur bashkë me Verën ndër vite. Le të citojmë diçka nga poezia

"KËNDOJ PËR TY"

"Shpirti i poezisë krahas me hyjni / Herë ziliqare e herë melankoli / Për ndjenjat e valëzuara / ngremë nga një doli ..!"

Kur i hapa në kompjuter këto poezi menjëherë më shkoi mendja ti ul në tavolinë si të ishin gurë shahu!

Nuk e kisha aspak të vështirë që të dalloj fuguat kryesore, sepse autorja shkruan me gjithë shpirt për prindërit

e saj. Me nostalgji, respekt, dhimbje dhe vlerësim na sjell atë stil vargjes, që zakonisht çdo poet i ka në librin e parë.

Askush nuk do të donte, që dashurinë e parë ta kalonte nëpër gojë e botës askush nuk do të donte që librin e parë t'ja gozhdonte me shigjeta kritike. Mendoj se për znj. Vera ky libër është një frymëzim i brendshëm, pastaj një dhuratë për veten dhe familjen e saj..

Kam parë aty disa poezi për fëmijët, mbesën, bashkëshortin nuk po citoj asnjërin nga ato por më kanë bërë përshtypje epitetet e përdorura: "dritë ylberet e mi, faqemolla e gjyshes, shpirt-profil i bukur".

"SHPIRTI I LIRISË"

"Në bllokun e shpirtit ca mendime hodha / si fillim hodha vargje ato të dashurisë / tjera që më ngelën sërish sistemova / për hir të pushimeve e shpirtit të lirisë"

Dashuria është bakllavë e çdo poeti, nuk kishte si të mungonte në këtë libër të shkruar nga një zonjë, që siç duket i ka humb çelësi i viteve. Lulet, liqeni, deti, fluturat, ylberi, por edhe loti melankolik janë subjekt dhe objekt në lirikën e librit.

Por kur është fjala për dashurinë tregohet shumë e rreptë!?

Në këtë libër ka një kolor ngjyrash dhe tematike, Kosova dhe Reçi, Malësia dhe Kukësi, Milano dhe Velipoja prandaj është një relike në bibliotekën tonë, është një emocion që autorja e ka ruajt gati me fanatizëm deri sot.

Populli thotë se, çdo nuse shkëlqen në ditën e dasmës, prandaj unë nuk kërkoj kurrë ku ka pikuar çatia në faqet e një libri, për mua çdo poezi është një meteor.

Le të zbërthejmë vetëm dy vargje nga poezia"

"DOJA CA METEORË"

"Të thurë për ty vargje si kurorë / Të bashkuara vullkani me meteorë"

Me plot bindje mundem të them se ky libër, është vullkan i shpirtit të saj, një vullkan që ka peshkuar meteorë në qiellin e ëndrrave.

Urime artiste!

Mirë se erdhët në familjen e miqve të librit, shpirti juaj paqësor dhe poetik është një pasuri që kur e kthen në poezi dhe bamirësi, vlen shumë për shoqërinë.

"Durimit nuk i bëhet jehonë / Ai është si një nuse ne duvak"

Me këto vargje që gjenden në një poezi të këtij vëllimi do e mbyll këtë pasthënie. Mendoj se durimi është babai i suksesit dhe guximi nëna e tij. Ju guxuati dhe i'a keni arritur të jeni një grua e suksesshme. Ju keni duruar me vite frymëzimin tuaj poetik për ta sjell sot në të parim libër me poezi. Nga flatrat e mallit uroj që të hapen horizonte të reja për ju!

Le te jete ky opinionin i imi një kafe relaksi para se të lexojnë poezitë tuaja! Suksese!

LULASH BRIGJA,
Shkodër - Korrik 2024

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj

Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin
LAZËR ÇARDAKU

